

Imazhi çon peshë!

~Shtjellimi i problemit rreth imazhit të Kosovës~

Ky raport është hartuar dhe botuar me ndihmën zemërgjerë të KFOS-it.

Copyright ©IKS.

~PËRMBAJTJA~

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	2
VRIMA E ZEZË E EVROPËS?	4
NUK ËSHTË NË SHITJE.....	6
PERËNDIMI I EGËR I EVROPËS.....	12
KËRCËNIMI SHQIPTAR	16
PERCEPTIMI DHE REALITETI.....	20
THEMBRA E AKILIT E KOSOVËS.....	26
BETEJA ME SFIDAT E VËRTETA.....	29
E TASH ÇKA? (PËRFUNDIM).....	34

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kosova vuan nga një problem serioz i imazhit. Në shumë vende evropiane, emri ‘Kosovë’ sjell pamje të konfliktit etnik dhe të krimit të organizuar. Prandaj, institucionet qeveritare dhe shoqëria civile duhet të ndërmarrin një përgjigje të bashkënduar. Imazhi është i rëndësishëm; posaçërisht për një shtet të ri si Kosova që aspiron të bëhet pjesë aktive e diplomacisë botërore, të josh investime të huaja dhe t’i përmbush aspiratat euro-atlantike. Duke u mvarrur nga njohjet ndërkombëtare, reputacioni i vendit ka rëndësi të jashtëzakonshme.

Ky raport ka për qëllim t’i sfidoj klishetë ndërkombëtare dhe mendimet e përgjithshme për Kosovën. T’i përmendim vetëm disa prej tyre: Transparency International e rendit Kosovën si vendin e katërt më të korruptuar në botë. Freedom House e rendit Kosovën në vend të njejtë me Çadin sa i përket të drejtave dhe lirive politike. Departamenti Amerikan i Shtetit e përshkruan Kosovën si vend burim dhe destinacion për trafikimin e qenieve njerëzore. Mediat në Beograd raportojnë për dhunë të vazhdueshme ndëretnike. Këshilli i Evropës paralajmëron për rrezikun e jashtëzakonshëm që i kanoset BE-së nga grupet etnike kriminale shqiptare. Interpoli pohon që trafikuesit shqiptarë të drogës kontrollojnë 80 përqind të furnizimit me heroinë në Evropë, dhe UNDP-ja paralajmëron se në shtëpitë kosovare gjenden më tepër se 300,000 armë ilegale. Cila është e vërteta?

Kur shikuar më thellë, kemi vërejtur se hendeku në mes perceptimit dhe realitetit në terren është shumë i madh. Kosova më nuk është vend i dalë nga konflikti; shkalla e vrasjeve në Kosovë është pothuajse e njejtë më atë në Suedi dhe për kokë banori Kosova ka më shumë policë se Singapuri. Irlanda Veriore ka rreth 960 përqind më tepër krime të dhunshme se Kosova. Një studim i UNDP-së tregon që vetëm 15 përqind të të anketuarve i mbështesin vlerësimet e tyre për korrupsion në bazë të përvojës personale; sipas Këshillit të Evropës, shumica e punëtorëve të seksit në Ballkan sot punojnë me dëshirën e tyre. Me 18 armë për çdo 100 banorë, krahasuar me rastin e Finlandës e cila ka 69 armë për çdo 100 banorë, pyetemi pse Kosova dhe jo Finlanda përshkruhet si parajsë e revolveristëve. Në fakt, rajoni i Ballkanit është njeri prej rajoneve më të sigurta në Evropë.

Nëpërmjet këtij raporti, ne dëshirojmë ta ngrisim vetëdijen dhe të nxisim një debat. Por në të njejtën kohë i bëjmë thirrje institucioneve kosovare që të punojnë më tepër në reformimin e gjyqësorit, në luftën kundër korrupsionit në qeveri dhe biznes, në furnizimin e forcës policore dhe në bashkëpunimin me ligjvënësit në Evropë për ta luftuar krimin e organizuar. Gjyqësori është pa dyshim hallka më e dobët në administratën publike kosovare. Ky fakt nuk mund të ndryshohet me një fushatë të imazhit; kjo kërkon punë të jashtëzakonshme dhe përqendrim politik.

Për ta riformësuar imazhin e një vendi, sigurisht kërkohet më tepër se vetëm një spot televiziv në CNN. Kosova duhet ta kuptojë origjinën e problemit rreth imazhit të saj dhe si dallon kjo në krahasim me vendet e ndryshme. E dyta, Kosova duhet të vlerësojë me kujdes se çka gjindet prapa klisheve dhe perceptimeve ndërkombëtare. Si rezultat, Kosova ndoshta do të duhet të ballafaqohet me të vërteta të pakëndshme dhe do të duhet t'i adresoj ato në mënyrë të drejtpërdrejt.

Kosovës nuk do t'i duhet ta zbulojë ujin e nxehtë; ka mësim që mund të mësohen nga vendet e tjera të cilat me sukses e kanë ndryshuar imazhin e tyre. Një gjë është e sigurtë, për të qenë e suksesshme në këtë drejtim Kosova do të duhet të ndërtojë aleanca me të gjitha subjektet politike, përfshirë këtu edhe organizatat joqeveritare, mediat dhe bizneset. Imazhin e Kosovës nuk mund ta ndryshojë vetëm Ministria e Punëve të Jashtme – ndryshimi i imazhit kërkon partneritet dhe dialog të vërtetë me shoqërinë civile.

VRIMA E ZEZË E EVROPËS?

Kosova vuan nga një problem i ndjeshëm i imazhit. Anëmbanë Evropës, emri ‘Kosovë’ sjell pamje të konfliktit etnik, krizës politike dhe të krimit të organizuar. Gazetat kryesore evropiane, posaçërisht në shtetet ku jetojnë komunitete të mëdha të emigrantëve shqiptarë, e përshkruajnë Kosovën si ‘shtet mafioz’ dhe si vend i sigurt për kriminelë dhe trafikantë të drogës, me institucione të dobëta dhe të udhëhequra nga rrjete të korruptuara familjare.

Një raport i botuar rishtazi nga një institut gjerman,¹ e përshkruan Kosovën si shoqëri mafioze të mbështetur në kontrollimin e shtetit nga elementët kriminale, një ndërmarrje shumë-milionëshe e bazuar në përvojën e guerilëve dhe ekspertizës së spiunazhit. Si dëshmi përkrahëse, raporti përmend 40,000 lëndët e pazgjidhura gjyqësore, mungesën e hetimeve kundër korrupsionit dhe krimit dhe shtrirjen e gjerë të pompave të benzinës që shërbejnë si pararojë e shtëpive publike dhe larjes së parave. Raporti nuk e kursen as komunitetin e OJQ-ve, duke pohuar që shumica e 2,400 OJQ-ve kosovare ekzistojnë vetëm për qëllime të dyshimta.²

‘Kolumbia’ e Evropës, është një emër tjetër që përdoret shpesh për ta përshkruar rolin e supozuar të Kosovës si furnizuese e madhe e drogës në Evropë. Gazeta Guardian flet për Kosovën si vend i sigurt për kontrabandë dhe i cili furnizon deri në 40 përqind të heroinës që shitet në Evropë dhe në Amerikën Veriore. Kjo gazetë poashtu citon Marko Nicoviq, avokat dhe zyrtar i luftës kundër narkotikëve në qytetin e Nju Jorkut, se ‘Kosova është unaza më e vështirë për t’u shkatërruar sepse e tëra udhëhiqet nga familjet.’³

Përveç medimeve që ndjekin vetëm tituj bombastik, edhe disa botime serioze ndërkombëtare e kanë ritheksuar imazhin negativ të Kosovës. Në vitin 2007,⁴ Transparency International e renditi Kosovën si vendin e katërt më të korruptuar në botë. Në fushën e të drejtave politike dhe lirive civile, Freedom House e renditi Kosovën në pozitën e njetë me Sudanin dhe Chadin. Në një raport të Departamentit Amerikan të Shtetit, Kosova përmendet si ‘burim, transit dhe destinim i femrave dhe fëmijëve të trafikuar ndërkombëtarisht dhe brenda vendit për qëllime të shfrytëzimit komercial seksual.’⁵

¹ Kosova – një shoqëri mafioze, David Binder, Balkananalysis, 23 shkurt 2008, cituar nga raporti i titulluar ‘Operacionalizimi i Reformës në Sektorin e Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, botuar nga Instituti për Politika Evropiane i autorizuar nga Bundesëehr gjerman, Mathias Joop & Sammi Sandaëi

² Kosova – një shoqëri mafioze, David Binder, Balkananalysis, 23 shkurt 2008, cituar nga raporti i titulluar ‘Operacionalizimi i Reformës në Sektorin e Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, botuar nga Instituti për Politika Evropiane i autorizuar nga Bundesëehr gjerman, Mathias Joop & Sammi Sandaëi

³ Furnizimi i heroinës nga mafia kosovare e drogës në Evropë, The Guardian, World News, 13 mars 2000

⁴ ‘Raporti i Barometrit të Korrupsionit Global i Transparency International 2007,’ botuar nga Transparency International – 6 dhjetor 2007

⁵ Raporti mbi Trafikimin e Personave, Departamenti Amerikan i Shtetit, qershor 2007, f.180

Për shkak të ndjeshmërisë së problemit rreth imazhit të Kosovës në vendet e tjera, është e natyrshme për politikbërësit dhe shoqërinë civile që t'i rrudhin krahët në shenjë të dëshpërimit. Mirëpo, ky dokument argumenton që Kosova nuk guxon të rrijë duarkryq. Reputacioni ndërkombëtar i një vendi ndikon në aftësinë e tij që të angazhohet në arenën ndërkombëtare dhe të josh investime, biznese dhe turistë. Imazhi është i rëndësishëm në mënyrë që Kosova ta kthej në rrugë të mbarë ekonominë e saj, të bëhet anëtare e institucioneve ndërkombëtare dhe t'i realizoj aspiratat euro-atlantike.

Madje, në rastin e Kosovës, imazhi ka rëndësi edhe më të madhe. Deri sot, Kosova është njohur vetëm nga 52 prej 192 vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara.⁶ Pesë vende anëtare të Bashkimit Evropian, Spanja, Greqia, Qipro, Rumania dhe Sllovakia, refuzojnë të njohin pavarësinë e Kosovës. Ministria e Punëve të Jashtme e Qeverisë së Kosovës, e krijuar rishtazi, gjendet para një rruge të vështirë për t'i bindur homologët në Bukuresht dhe Madrid që Kosova e meriton një ulëse në tavolinën evropiane. Për të qenë e suksesshme, kjo Ministri duhet jo vetëm ti kuptoj realitetet politike në vendet e caktuara, por poashtu duhet të dijë edhe si ta kthej opinionin publik në favor të saj. Në rast se ajo dështon, aspiratat euro-atlantike të Kosovës do të mbeten ëndërr e largët.

IKS beson se e ardhmja e Kosovës është në Evropë; dhe kjo është arsyeja pse ne e marrim seriozisht çështjen e imazhit negativ të Kosovës. Ky dokument synon të shikoj për së afërmi dhe ti sfidoj disa prej pohimeve më të shpeshta. Dokumenti nuk pretendon të jetë gjithëpërfshirës; ne jemi përqendruar në trafikimin e qenieve njerëzore dhe të narkotikëve, në armët ilegale, në korrupsion, në mungesën e përgjithshme të sundimit të ligjit dhe në krimin ndëretnik – 'përbërësit' e zakonshëm të 'krimit të organizuar.'

Si pikënisje, ne mblodhëm të dhënat në dispozicion dhe statistikën e krimit. Kjo ishte sfida e vërtetë për shkak të mungesës së jashtëzakonshme të të dhënave dhe sistemeve të dobëta të mbledhjes së të dhënave. Mandatet e ndryshme dhe zbrazëtitat institucionale në mes të policisë së Kombeve të Bashkuara dhe Policisë së Kosovës e komplikuan edhe më tepër këtë detyrë. Së dyti, ne u përqendruam në atë që 'ekspertët' e kësaj fushe kishin për të thënë dhe i konsultuam vlerësimet e ndryshme të agjencive të njohura ndërkombëtare siç janë Banka Botërore, Freedom House apo Transparency International. Së treti, ne shikuam për së afërmi kapacitetin institucional të institucioneve aktuale kosovare për ofrimin efikas të sundimit të ligjit dhe të luftës kundër krimit të organizuar. A po lëviz Kosova përpara apo po rrëshqet prapa, a ka trende pozitive dhe ku janë zbrazëtitat dhe sfidat e mbetura? Këto janë disa prej pyetjeve që shpresojmë ti trajtojmë.

Kosova padyshim ka nevojë për shumë më tepër diskutime që bazohen në kërkime dhe dëshmi për burimin e krimit dhe për mënyrat më të mira për ta luftuar atë. Injorimi i problemit vetëm sa e përkeqëson atë. Në anën tjetër, për ta shtuar numrin e vendeve që e

⁶ www.kosovothanksyou.com, 6 nëntor 2008

njohin Kosovën, për ta kthyer në favor të saj opinionin publik në Evropë dhe për të vepruar me efikasitet në arenën ndërkombëtare, Qeveria dhe shoqëria civile kosovare duhet ta kuptojnë më mirë problemin e imazhit të saj dhe të hartojnë një ‘brend të ri kombëtar.’ Krijimi i brendit të ri kombëtar është sfidë që nganjëherë përfshin edhe ballafaqimin me të vërtetat e papërshtatshme.

Vendet e tjera, në të kaluarën, kanë qenë të suksesshme në përmirësimin e imazhit të tyre. Edhe Kosova mund ta bëjë këtë. Qëllimi i këtij dokumenti është pikë së pari ti sfidoj disa klishe dhe të nxis debat.

NUK ËSHTË NË SHITJE

Me premtimin që do t’iu sigurojnë vende legjitime të punës, Vladimir Ukaj, Robert Sylaj dhe Sabri Islami kishin joshur një vajzë 16 vjeçare nga Shqipëria dhe një viktimë tjetër që të vijnë në Kosovë. Destinacioni i tyre final: një bar në Prizren. Puna e tyre gjatë 24 orëve: prostitucioni i detyrueshëm.

Që nga vera e vitit 1999, tregu dikur i vogël lokal i prostitucionit u shndërrua në një industri të madhe të bazuar në trafikimin e udhëhequr nga rrjetet e organizuara kriminale.⁷ Amnesty International vlerësonte që numri i vendeve në Kosovë ku mund të shfrytëzohen gratë dhe vajzat e trafikuar është rritur dhjetëfish prej 18 në vitin 1999 në 200 në vitin 2003.⁸ Paqeruajtësit – të cilët atëbotë përbënin 2 përqind të popullsisë së Kosovës – përbënin 20 përqind të personave që shfrytëzonin shërbimet e grave dhe vajzave të trafikuar.⁹ Sipas raportit të botuar nga ODIHR në vitin 2002, shkalla e klientëve ndërkombëtarë kishte arritur 40 përqind.¹⁰ Në vitin 2003, kur Ukaj, Sylaj dhe Ismaili erdhën në Kosovë nga Shqipëria për ta fituar hisen e tyre në biznesin fitimprurës, zbatimi i ligjit ishte në duart e policëve të Kombeve të Bashkuara.

Në vitet e para të pasluftës, sipas burimeve të UNMIK-ut, 98 përqind e të gjitha viktimave të trafikuar në Kosovë ishin nga Evropa Juglindore dhe Lindore. Studimet në vitin 2004 tregonin që pjesa dërrmuese e viktimave ishin nga Moldavia dhe Rumania – respektivisht 53 përqind dhe 23 përqind.¹¹

Sipas agjencive për zbatimin e ligjit dhe organizatave të drejtave të njeriut, rrjetet e organizatave kriminale nga Serbia dhe Maqedonia furnizonin shtëpitë publike në Kosovë.

⁷ Amnesty International. Kosova: Paqeruajtësit ndërkombëtarë nxisin shpërthimin e shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe mizeries njerëzore. Maj 2004

⁸ Amnesty International. Kosova: Paqeruajtësit ndërkombëtarë nxisin shpërthimin e shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe mizeries njerëzore. Maj 2004

⁹ Amnesty International. Kosova: Paqeruajtësit ndërkombëtarë nxisin shpërthimin e shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe mizeries njerëzore. Maj 2004

¹⁰ Krimet e motivuara etnikisht në Kosovë, Raport Informues, 2004, duke cituar një raport të UNICEF/OSCE – ODIHR, të botuar në qershor të vitit 2002.

¹¹ UNMIK. Luftimi i Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Kosovë: Strategjia & Përkushtimi. Maj 2004

Shumica e femrave të trafikuar, rreth 62 përqind, hynin në Kosovë nga Serbia, dhe 22 përqind futeshin nga Maqedonia. Trafikuesit shfrytëzonin mungesën e kontrollit të mirëfilltë në vendkalimet kufitare dhe shtigjet e pashkelura që rrallëherë patrolloheshin nga policia dhe paqeruajtësit.¹² 79 përqind të femrave të trafikuar që arritën në Kosovë deri në vitin 2004, kishin marrë premtime të rrejshme për punësim, derisa 8 përqind prej tyre ishin kidnapuar.¹³ Kështu UNMIK-u e përshkroi gjendjen në vitin 2004, por si është gjendja sot?

Është me rëndësi të ceket se Kosova nuk është vendi i vetëm që has në vështirësi në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Të dhënat për femrat e mitura të kontrabanduara, kidnapuara dhe të droguara i kanë dhënë Ballkanit epitelin e 'epiqendrës të trafikimit me qenie njerëzore'.¹⁴ Raportet alarmante të organizatave për të drejtat e njeriut dhe mediave kanë çuar në rritjen e spekulimeve për numrin e femrave dhe fëmijëve që trafikohen çdo vit përmes Ballkanit.¹⁵ Për vite me radhë, numri 'zyrtar' i viktimave të trafikuar arrinte në 120,000.¹⁶

Mirëpo nëse shikojmë më afër, ka shumë pak dëshmi që e mbështesin këtë pohim. IOM, organizata e njejtë që dikur kishte botuar vlerësimin zyrtar për 120,000 viktima të trafikimit, tash vonë ka deklaruar se 'më nuk e mbështet këtë numër, nuk mund të thotë se cili ishte burimi i këtij numri në rend të parë, dhe aktualisht nuk mund të ofroj një vlerësim të azhurnuar apo alternativ.'¹⁷ Në fakt, IOM u distanca nga vlerësimi i mëhershëm duke thënë se 'këto statistika ishin të vjetruara.'¹⁸ Në vitin 2006, Këshilli i Evropës konkludoi që 'nuk ekzistojnë statistika apo numra të saktë.'¹⁹ Por çka dimë ne në të vërtetë për trafikimin e qenieve njerëzore sot?

Vlerësimi i fundit u botua në vitin 2004 dhe mbështetet në informatat e mbledhura në 15 vende kyçe të destinimit në Evropë. Sipas këtij studimi, numri i viktimave të trafikimit në vit është rreth 25,000.²⁰ Nëse vlerësimet e mëhershme të IOM-it ishin sado pak të vërteta, kjo do të thotë se ekziston një rritje dramatike e trafikimit të qenieve njerëzore.

Disa studime në mbarë rajonin konfirmojnë rënie të përgjithshme dhe një kalim nga prostitucioni i detyrueshëm në punë vullnetare të prostitucionit; një rritje në trafikimin e brendshëm dhe rritje në shtëpitë e vogla publike. Një studim i vitit 2004 për mbarë Evropën zbuloi që 59 përqind të viktimave të identifikuar ishin nga Rumania, 35 përqind

¹² Amnesty International. Kosova: Paqeruajtësit ndërkombëtarë nxisin shpërthimin e shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe mizeries njerëzore. Maj 2004

¹³ UNMIK. Luftimi i Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Kosovë: Strategjia & Përkushtimi. Maj 2004.

¹⁴ Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan dhe vendet e ndikuara, Zyra e OKB-së për Drogë dhe Krim, Mars 2008, f.75.

¹⁵ Raport i IOM. 2001

¹⁶ Europol, Trafikimi i Femrave dhe Fëmijëve për Shfrytëzim Seksual në BE: Involvimi i Krimin të Organizuar në Ballkanin Perëndimor 2006, Hagë, Europol, f.4-5

¹⁷ Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan dhe vendet e ndikuara, Zyra e OKB-së për Drogë dhe Krim, Mars 2008, f.75.

¹⁸ Komunikatë personale nga Sarah Louise Craggs, Hulumtuese në divizionin Kundër Trafikimit, IOM, 15 tetor 2007.

¹⁹ Këshilli i Evropës. Raporti i Gjendjes 2006 mbi Krimin e Organizuar dhe Ekonomik në E.JL

²⁰ Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan dhe vendet e ndikuara, Zyra e OKB-së për Drogë dhe Krim, Mars 2008

nga Bullgaria dhe vetëm 6 përqind prej tyre ishin të nacionaliteteve tjera. Me fjalë të tjera, 94 përqind të viktimave të identifikuar nuk duhet të kontrabandohen fare sepse ato janë nga vendet anëtare të BE-së dhe mund të udhëtojnë lirshëm dhe pa kufizime të vizave në Evropën Perëndimore.²¹ Këshilli i Evropës, në raportin mbi krimin e organizuar, thotë që në Ballkan femrat në biznesin e seksit ‘duket se punojnë me dëshirën e tyre,’ dhe që shumica e femrave të përfshira në prostitucion tashmë kanë ‘dokumente valide dhe kontrata të punësimit.’²²

Këtë trend e mbështesin edhe të dhënat që vijnë nga Italia, vend kyç i destinimit dhe dikur vend i sigurt për viktimat e trafikimit nga Shqipëria. Gjatë viteve të 90-ta, shumica e punëtorëve të seksit, rreth 40 përqind, besohet të ishin shqiptare. Në vitin 2003, vetëm 15 përqind të femrave të trafikuar ishin shqiptare. Numri i femrave të trafikuar shqiptare shënoi rënie të mëtutjeshme dhe në vitin 2006 vetëm 2 përqind të viktimave të regjistruara të trafikimit me qenie njerëzore ishin shqiptare.²³

Milefi publik kundër krimeve çnjerëzore siç janë trafikimi i qenieve njerëzore dhe prostitucioni ka çuar në një përgjigje të fuqishme nga donatorët, qeveritë dhe OJQ-të në rajon. Trafikimi i qenieve njerëzore nga Evropa Juglindore poashtu ka fituar hapësirë më të madhe mediale se çdo problem tjetër i trafikimit në botë. Si rezultat i kësaj, lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore u shpall prioritet edhe në Kosovë.

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë në vitin 2000 ndërmoi hapat e parë për trajtimin e trafikimit të qenieve njerëzore, duke themeluar Njësinë Hetuese për Trafikim dhe Prostitucion (TPIU). Në janar të vitit 2001, UNMIK-u miratoi Rregulloren 2001/4 mbi ‘Ndalimin e Trafikimit të Njerëzve në Kosovë,’ ku parashihej ndjekja dhe dënimi i personave të përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore.

Po atë vit, policia e UNMIK-ut lëshoi një urdhëresë për vendet e ndaluara, me ç’rast stafit të UNMIK-ut i ndalohej frekuentimi i lokaleve dhe vendet e tjera të dyshimta të argëtimit.

Janë miratuar edhe rregullore të tjera për ndalimin e kalimit të paautorizuar të kufijve, për mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve bashkëpunues në rastet kriminale, dhe për rregullimin e përgjimit dhe masave tjera të hetimit.²⁴ Shumica e këtyre rregulloreve janë përfshirë në Kodin e Përkohshëm Penal dhe në Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, që hynë në fuqi më 6 prill 2004.

²¹Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan dhe vendet e ndikuara, Zyra e OKB-së për Drogë dhe Krim, Mars 2008

²²Këshilli i Evropës. Raport i Gjendjes 2006 mbi Krimin e Organizuar dhe Ekonomik në EJL

²³Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan dhe vendet e ndikuara, Zyra e OKB-së për Drogë dhe Krim, Mars 2008, f.78

²⁴UNMIK. Luftimi i Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Kosovë, Strategjia & Përkushtimi, Maj 2004.

Neni 139 thotë që trafikuesi mund të dënohet prej 12 deri në 20 vite burgim. Kushdo që blen apo përdor shërbimet seksuale të një personi duke e ditur që ky person është viktimë e trafikimit kryen krim dhe mund të kalojë deri në 5 vite në burg.²⁵ Në raportin vjetor për trafikimin e qenieve njerëzore, Departamenti Amerikan i Shtetit lavdëroi Kosovën për Kodin e saj Penal, sepse ky i fundit parasheh dënime të ashpra për trafikimin e qenieve njerëzore.²⁶

Përveç këtyre ligjeve, në shkurt të vitit 2002, Departamenti i Drejtësisë ndërmori një qasje të orientuar më tepër kah viktimat duke krijuar Njësinë për Avokim dhe Ndihmë të Viktimave. UNMIK-u gjithashtu mori pjesë në Inicativën e Evropës Juglindore për Bashkëpunim (SECI), e themeluar për t'i bashkërenduar përpjekjet e hetimeve rreth trafikimit të qenieve njerëzore në rajon. Njësi kundër Trafikimit filloi të shkëmbejë informata rreth trafikimit të qenieve njerëzore me forcat policore të vendeve anëtare të SECI-të. Në dhjetor të vitit 2002, UNMIK-u nënshkroi në emër të Kosovës 'deklaratën e përkushtimit ndaj legjislacionit për Statusin e Personave të Trafikuar.' Të gjitha shtetet që e nënshkruan deklaratën u betuan se do të: përmirësojnë identifikimin e personave të trafikuar, përmbahen nga dëbimi i tyre i menjëhershëm, t'i dërgojnë viktimat nëpër strehimore, t'iu japin viktimave leje të përkohshme të qëndrimit, të hartojnë programe për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të caktojnë gardianë për fëmijët e trafikuar. UNMIK-u nënshkroi një dokument tjetër të ngjashëm më 10 dhjetor 2003. 'Përkushtimet për Legjislacionin e Statusit të Personave të Trafikuar' i obligon shtetet nënshkruese të hartojnë ligje për mbrojtjen e viktimave që dëshmojnë dhe garanton të drejtat siç janë dëshmitë me anë të video konferencës për parandalimin e traumës së dytë gjatë procesit gjyqësor.

Me transferin gradual të kompetencave nga UNMIK-u, autoritetet vendore filluan të marrin iniciativë më të madhe në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Në fund të vitit 2003, Qeveria e Kosovës emëroi Koordinatorin Ndërmnistror për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Pas kësaj u themelua edhe Grupi Punues Ndërmnistror për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore.²⁷ Grupi Punues organizoi një konferencë ndërkombëtare në Prishtinë, ku morën pjesë më tepër se 300 pjesëmarrës. Si rrjedhojë e konferencës, në maj të vitit 2005, Qeveria lansoi Planin Kosovar të Veprimtimit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

Në vitet 2005 dhe 2006, u organizuan katër fushata të mëdha të vetëdijesimit. Prej janarit deri në qershor të vitit 2006, Koordinatorin dhe Sekretariatin për Anti-Trafikim, me ndihmën financiare të IOM-it, dizajnoi një uebfaqe për masat e anti-trafikimit në Kosovë. Në nëntor të vitit 2005, Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut, Njësi për Avokim dhe

²⁵ Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, Neni 139, Prill 2004.

²⁶ Departamenti Amerikan i Shtetit. Raport për Trafikimin e Qenieve Njerëzore 2008. Qershor 2008.

²⁷ Pjesëtarët janë përfaqësues nga zyra e kryeministrit, ministria e arsimit, ministria e kulturës, ministria e mirëqenies sociale, ministria e shëndetësisë dhe ministria e shërbimeve publike.

Ndihmë për Viktimat dhe Ministria e Arsimit, OSBE-ja dhe Zyra Amerikane promovuan fushatën *Nuk është në shitje*.²⁸

Në vitin 2005, me ndihmën e IOM dhe UNICEF, Ministria për Arsim rihartoi kurrikulën për klasat 6-11 dhe futi temën e trafikimit të qenieve njerëzore në kurset dhe tekstet shkollore ekzistuese. Po atë vit, Ministria e Drejtësisë dhe Telekom i Kosovës hapën një linjë telefonike pa pagesë për t’iu ofruar ndihmë viktimave të trafikimit.²⁹ Ndëkohë që në regjione të ndryshme të Kosovës janë themeluar tri Zyra Mbrojtëse për Viktimat. Në Kosovë sot operojnë pesë strehimore për viktimat e trafikimit.³⁰ Në korrik të vitit 2007, Kryeministri shpalli muajin tetor muaj të vetëdijësimit kombëtar për çështjen e trafikimit. Gjatë viteve, donatorët kanë financuar programe të shumta për trajnimin e prokurorëve, gjykatësve dhe mësuesve për trafikimin e qenieve njerëzore dhe viktimat e tyre.

Kronologjia e masave në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore

Tetor 2000	Themelimi i Njësisë Hetuese për Trafikim dhe Prostitucion
Janar 2001	Rregullorja 2001/4 “Ndalimi i Trafikimit të Personave” Udhëzimi i Policisë së UNMIK-ut për “Vendet e Ndaluar”
Shkurt 2002	Departamenti i Drejtësisë themelon Njësinë për Avokim dhe Ndihmë të Viktimave UNMIK-u merr pjesë në SECI
Dhjetor 2002	UNMIK-u nënshkruan “deklaratën për përkushtim ndaj legjislacionit për Statusin e Personave të Trafikuar”
Tetor 2003	Grupi Punues ndërministror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore Konferenca ndërkombëtare për trafikimin e qenieve njerëzore (300 pjesëmarrës)
Maj 2005	Plani Kosovar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
2005-2006	Disa fushata të vetëdijësimit & iniciativa të ndryshme Tema e Trafikimit të Qenieve Njerëzore përfshihet në tekstet shkollore
Gusht 2005	Linja telefonike pa pagesë për ofrimin e ndihmës për viktimat
2008	Pesë strehimore funksionale për viktimat në Kosovë

Një natë në fund të vitit 2003, Policia Ushtarake e KFOR-it që dyshonin në aktivitetet brenda lokalit “Pashtriku” në Prizren, e lajmëruan Njësinë Hetuese të Trafikimit dhe Prostitucionit. Po atë natë, policia shpëtoi viktimat 16-vjeçare të trafikimit nga Shqipëria dhe arrestoi Ukajn, Sylajn dhe Islamin. Bastisja në lokalin “Pashtriku” ishte njëra prej 2,836 kërkimeve nga ana e policisë dhe paqeruajtësve në gjysmën e dytë të vitit 2003 dhe në gjysmën e parë të vitit 2004.³¹ Më 20 korrik 2005, tre trafikantët nga Shqipëria dolën para panelit prej dy gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe një gjykatësi vendor në Gjyqin e Qarkut në Prizren. Gjërat kishin ndryshuar dhe tash viktimat po iu ndihmonin prokurorëve në ndërtimin e rastit për trafikim të qenieve njerëzore, për lehtësim të prostitucionit dhe për falsifikim të dokumenteve. Ukaj dhe Sylaj u dënuan me 12 vite në

²⁸ Qendra Ligjore e Kosovës. http://www.kosovolaecenter.org/english/traffic_monitoring.html

²⁹ Komisioni Evropian. Raporti i Progresit për Kosovën 2006

³⁰ Instituti për Shoqëri të Hapur. Dhuna kundër Gruas: A çan kokën qeveria në Kosovë?

³¹ Raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit për Trafikim nga qershori 2003 deri qershor 2008

burg, ndërsa Islami me 10 vite burgim. Ky dënim ishte ndëshkimi më i lartë në historinë e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë.³²

Kjo tregon që përgjigja zyrtare në Kosovë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore ka qenë mjaft efektive. Të dhënat e Policisë së Kosovës konfirmojnë rënien e qëndrueshme të numrit të viktimave.³³

Viti	Numri i viktimave që kanë marrë ndihmë
2001	172
2002	89
2003	70
2004	58
2005	55
2006	65
2007	32

Burimi: Statistikat e Policisë së Kosovës

Renditja e viktimave në bazë të nacionalitetit të tyre tregon që ka rënie graduale në trafikimin tejkuftar të qenieve njerëzore, derisa i ashtuquajtimi ‘trafikimi i brendshëm’ apo përdorimi i femrave vendore në tregun e prostitucionit ka shënuar rritje.³⁴

Viti	Nga Kosova	Nga Moldavia	Nga Rumania
2001	5	94	46
2002	3	32	19
2003	0	13	3
2004	39	16	4
2005	28	12	1
2006	18	30	N/A
2007	18	3	N/A

Burimi: Policia e Kosovës

Siç shihet në tabelë, në vitin 2001, shumica e viktimave të trafikuar ishin nga Moldavia, 55 përqind; 27 përqind nga Rumania, derisa femrat shqiptare nga Kosova përbënin 3 përqind të viktimave të trafikuar. Në vitin 2006, 28 përqind të viktimave ishin nga Kosova, dhe në vitin 2007 numri i femrave nga Kosova u dyfishua duke arritur përqindjen prej 56.2.³⁵

³² Komunikata për Shtyp e UNMIK-ut 1396. Gjykata kosovare shpall dënimin më të lartë me burgim për trafikuesit e qenieve njerëzore në Kosovë. Korrik 2005.

³³ Departamenti i Shtetit. Raport mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore 2004.

³⁴ Të dhënat e Shërbimit Policor të Kosovës

³⁵ Të dhënat e policisë së Kosovës, një trend i ngjashëm është vërejtur në vitin 2005 kur njësi kundër trafikimit ka bërë 2,000 bastisje, derisa në vitin 2006 u shënuan 99 operacione kundër trafikimit. Në çerekun e parë të vitit 2008, policia arriti të mbyll 27 shtëpi të dyshuara publike në Kosovë.

Krahasimi i të dhënave të vitit 2001 dhe 2007 dëshmon që policia është bërë më e aftë në ndërtimin e rasteve që kanë më tepër gjasa të rezultojnë me dënim në gjykatë.³⁶

Viti	Numri i rasteve	Numri i dënimeve
2001	n/a	15
2002	234	27
2003	69	17
2004	85	16
2005	70	22
2006	68	16
2007	58	24*

* Numri i dënimeve për vitin 2007 është marrë nga Raporti për Trafikim me Qenie Njerëzore i Departamentit Amerikan të Shtetit të vitit.

Kosova sigurisht nuk përbën përjashtim në rajon; dhe reputacioni i saj si vendi i origjinës, vend i transitit dhe destinacion për femrat dhe fëmijët e trafikuar nuk duket se e pasqyron realitetin në terren.

PERËNDIMI I EGËR I EVROPËS

Që nga përfundimi i konflikteve në Kosovë, disa studime kanë vlerësuar që shtimi i numrit të armëve ilegale në Kosovë kishte arritur nivel alarmues. Shumica e raporteve dhe e inteligjencës për kulturën e armëve në Kosovë e portretizojnë atë si shoqëri të gatshme të përdor armët në raste festimi (*trigger-happy*) si dhe të reagoj dhunshëm, dhe që frikësohet të heq dorë nga tradita shumë-shekullore.

‘Në Kosovë janë më tepër se 300,000 armë jashtë kufijve të ligjit.’ Me këtë deklaratë, përfaqësuesi i UNDP-së Robert Piper mirëpriti turmën e mysafirëve të nderuar në Teatrin Kombëtar të Prishtinës më 9 korrik 2003. Ngjarja ishte organizuar për të shënuar nisjen e fushatës tremujore për vetëdijesimin kundër armëve të shkurta në Kosovë. Katër vite më vonë, shefi i UNDP-së Frode Muring, deklaroi edhe një herë që ‘në Kosovë janë 300,000 armë ilegale.’³⁷ Për vite me radhë, ky ka qenë mendimi i përgjithshëm. Kosova është Perëndimi i Egër i Evropës.

Numri shpeshherë i përmendur dhe rrallëherë i kontestuar për ‘300,000’ armë ilegale na nxiti kureshtjen. Duke kërkuar origjinën e këtij pohimi, ne hasëm në një studim të vitit 2003 të titulluar ‘Kosova dhe Revolja,’ i autorizuar nga UNDP-ja.³⁸ Sipas këtij studimi, në Kosovë sot janë rreth 330,000 – 460,000 armë të vogla civile. Ekipi prej katër anëtarësh që hartoi këtë studim arriti në këtë numër duke supozuar se 60-70 përqind të shtëpive në Kosovë kanë mesatarisht 1.4 – 1.7 armë.³⁹ Burimi: ‘vlerësime të informuara

³⁶ Të dhënat e Shërbimit Policor të Kosovës

³⁷ Artikulli i datës 25 maj 2007 në <http://www.kosovo.undp.org/?cid=2,26,197>

³⁸ Kosova dhe Revolja: vlerësim themelor i armëve të shkurta dhe të lehta në Kosovë, i autorizuar nga UNDP-ja, qershor 2003

³⁹ Kosova dhe Revolja: vlerësim themelor i armëve të shkurta dhe të lehta në Kosovë, i autorizuar nga UNDP-ja, qershor 2003, f.2

të njerëzve që punojnë në degë të ndryshme të sektorit të sigurisë në Kosovë.’ Raporti nuk zbulon kush janë këta ‘informatorë’; por konkludon që ‘armët janë bërë pjesë e kulturës kosovare.’⁴⁰

Një studim tjetër për armët e vogla në Kosovë poashtu u mbështet në të ashtuquajtur ‘informatorë kyç.’ Sipas një hulumtimi të botuar në qershor të vitit 2006 nga Shtëpia Pastruese e Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe Armëve të Lehta (SEESAC) besohet se së paku 317,000 armë ishin në posedimin ilegal të qytetarëve dhe grupeve tjera.⁴¹ Vlerësimet e raportit edhe një herë bazohen në vlerësimin e informatorëve kyç që raportojnë që ose ‘çdo shtëpi në Kosovë ka një armë’ apo që ‘çdo shtëpi në Kosovë ka nga dy armë.’⁴² Nëse supozojmë të gjitha 357,100 familjet kanë nga një armë, dhe nëse e zbrisim numrin e përgjithshëm të armëve civile të regjistruara me leje dhe revoleve të policëve, atëherë raporti thotë që aktualisht duhet të jenë 317,000 armë të paregjistruara në qarkullim në Kosovë.⁴³ Duke marrë parasysh popullsinë prej 1.9 milion banorë, kjo do të thotë që çdo i gjashti person në Kosovë ka një armë ilegale, apo një armë ilegale për çdo të dytin mashkull më të vjetër se 15 vjet.⁴⁴

Në fakt, ekipi hulumtues përdori disa mënyra përfshirë këtu edhe studimin e familjeve në mbarë Kosovë me 1,258 respondentë, diskutime në grupe të fokusit, intervista me zyrtarë kyç dhe rishikimin e të dhënave zyrtare dhe raporteve në media. Megjithatë, për befasi, autorët vendosën ti largojnë rezultatet e ‘studimit të tyre’ të familjeve sepse ato ‘nuk përputhen me vlerësimet e informuara të informatorëve kyç.’ Autorët pohojnë që statusi i pazgjithur i Kosovës dhe mosgatishmëria për zbulimin e informatave nënkuptojnë që studimet e familjeve ‘nuk ofrojnë bazë të besueshme për vlerësimin e niveleve të posedimit të Armëve të Vogla dhe të Lehta.’ Prandaj, vështirimet e përgjithësuara të informatorëve kyç të pidentifikuar që pohojnë se çdo familje në Kosovë ka nga një armë trajtohen si burimi i vetëm i besueshëm.

Përkundër këtij pohimi, jo më tepër se 11,406 armë janë mbledhur gjatë konfiskimit të armëve dhe amnistive të ofruara në vitet 1999, 2001, 2002 dhe 2003.⁴⁵ Më pak se një përqind e kërkimeve të zakonshme me vetura rezultojnë me konfiskim të armëve. Gjatë amnistisë së armëve në vitin 2003, UNDP-ja madje ofroi më tepër se US\$ 225,000 në fonde zhvillimore për komunat që dorëzojnë më tepër se 300 armë ilegale. Përkundër këtij stimulimi, asnjë komunë nuk e arriti minimumin prej 300 armëve; në përgjithësi,

⁴⁰ Kosova dhe Revolva: vlerësim themelor i armëve të shkurta dhe të lehta në Kosovë, i autorizuar nga UNDP-ja, qershor 2003, f.31

⁴¹ Studim i SALË për Kosovën, Evropën Juglindore dhe Lindore, Shtëpia Pastruese për Kontrollin e Armëve të Shkurta dhe të Lehta (SEESAC), qershor 2006

⁴² Studim i SALË për Kosovën, Evropën Juglindore dhe Lindore, Shtëpia Pastruese për Kontrollin e Armëve të Shkurta dhe të Lehta (SEESAC), qershor 2006

⁴³ Studim i SALË për Kosovën, Evropën Juglindore dhe Lindore, Shtëpia Pastruese për Kontrollin e Armëve të Shkurta dhe të Lehta (SEESAC), qershor 2006, f.9

⁴⁴ Ky vlerësim merr parasysh tërë popullsinë e rritur të Kosovës, 1,362,300, dhe nuk përfshin fëmijët e moshës 0-14. Grupmosha 0-14 përbën 28.3 përqind të komuniteteve shqiptare, serbe dhe joserbe.

⁴⁵ Kosova dhe Revolva: vlerësim themelor i armëve të shkurta dhe të lehta në Kosovë, i autorizuar nga UNDP-ja, qershor 2003

vetëm 155 armë i janë dorëzuar vullnetarisht pikave mbledhëse të KFOR-it dhe policisë.⁴⁶

Sipas shënimeve të UNMIK-ut, në vitet 2004 dhe 2005 policia konfiskoi 4,026 armë, me një mesatare prej 167 armë në muaj. Revolet përbënin afër 40 përqind të të gjitha armëve të vogla të konfiskuara në vitet 2004 dhe 2005. Në rajonet e Prishtinës dhe Pejës u mbledhën më tepër se gjysma e armëve të vogla. Shkalla më e ulët e mbledhjes së armëve u shënuar në rajonin e Mitrovicës, që mund të jetë rezultat i hezitimit ndërkombëtar për të kërkuar armë në zonat e banuara me serbë me frikë nga provokimi i trazirave.

Vlerësimet dhe statistikat zyrtare për armët ilegale në Kosovë		
# Armët ilegale	317.000	100%
# Armët e mbledhura (1999-2003)	11,406	3.6%
# Armët e konfiskuara nga policia (2004-2005)	4,026	1.2%
Numri i përgjithshëm i armëve të konfiskuara/mbledhura	15,432	4.8%

Një gjë është e sigurtë, zbulimi i thelbit të posedimit të armëve ilegale është detyrë e vështirë në Kosovë. ‘Ka zbrazëti të mëdha në hartimin, mbledhjen dhe analizimin e statistikave të ndërlidhura me armët e vogla, nga institucionet kosovare të shëndetësisë dhe zbatimit të ligjit,’ konfirmon raporti i SEESAC.⁴⁷ Por për shkak të shkallës së ulët të kthimit, na mbetet të konkludojmë që ose përpjekjet ndërkombëtare për mbledhjen e armëve kanë dështuar plotësisht ose që nuk ka aq shumë armë ilegale sa supozohet?

Në fakt, ka indikacione të fuqishme që gjendja nuk është aq jashë kontrollit sa supozojnë statistikat për 317,000 apo 460,000 armë ilegale. Mediat bartin një pjesë të fajit; përveç statistikës bombastike prej 300,000 apo më tepër armë ilegale, shumë pak vëmendje i kushtohet se çka thojnë raportet tjera të ndryshme për trendet dhe zhvillimet e fundit.

Raporti i SEESAC në fakt sjell disa ‘lajme të mira’; Kosova më nuk është vend tranzit apo treg i kontrabandimit të armëve ilegale. ‘Ekipi hulumtues nuk kishte marrë asnjë dëshmi për transitin apo transportimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta nëpërmjet Kosovës në këtë kohë,’ dhe autorët pohojnë që për shkak të kontrollit dhe zbatimit të përmirësuar të ligjit, ‘kontrabandimi i armëve nuk është aktivitet i madh në kufijtë e Kosovës.’⁴⁸

Nëse kërkojmë më thellë, studimi i UNDP-së i vitit 2003 poashtu zbulon një pamje më të nuancuar për pronësinë e armëve dhe për kulturën e armëve në Kosovë. Për dallim nga konkludimi i studimit që Kosova është e stërbushur me armë ilegale, studimi sy-në-sy i


⁴⁶ <http://mirror.undp.org/kosovo/News/News.htm>

⁴⁷ Studim i SALË për Kosovën, Evropën Juglindore dhe Lindore, Shtëpia Pastruese për Kontrollin e Armëve të Shkurta dhe të Lehta (SEESAC), qershor 2006, f.v

⁴⁸ ‘Kosova dhe Revolja’, 2003, Khakeet dhe Florquin

ekonomive familjare dëshmon që ‘kosovarët nuk janë edhe aq të lidhur me armët e tyre siç besohet zakonisht.’⁴⁹ Në fakt, ‘vetëm pesë përqind besojnë që pothuajse të gjitha, shumica, apo çdo e dyta familje ka nga një armë.’⁵⁰ Dhe 54 përqind e të anketuarve u përgjigjen se nuk do të kishin vendosur të kenë armë edhe nëse do të ishte me leje.⁵¹ Këto përgjigje duket se e kundërshtojnë perceptimin e Kosovës si parajsë e revolveristëve.

Një raport tjetër i botuar më herët këtë vit nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Kontrollin e Drogës dhe Krimin poashtu konfirmon që Kosova më nuk është shoqëri e konfliktit ku të gjithë mbajnë nga një armë ilegale të zjarrit nën jastekun e tyre. Sipas studimit të UNODC, ‘pronësia e armëve të zjarrit për kokë banori është më e ulët në Evropën Juglindore sesa në shumë vende të Evropës Perëndimore.’⁵² Me 18 armë zjarri për 100 banorë, Kosova në fakt renditet më mirë se shumë vende anëtare të BE-së, më saktësisht Finlanda (69) dhe Suedia (40).



Burimi: Raporti i UNODC-së, 2008⁵³

Në vitin 1989, të dhënat zyrtarë jugosllave për pronësinë e armëve të zjarrit tregonin që Kosova kishte numër të përgjithshëm prej 65,540 të armëve me leje.⁵⁴ Kjo shkallë e 4.1 armëve për 100 banorë ishte mesatarja më e ulët në të gjitha rajonet e Jugosllavisë. Në të njëjten kohë, policia federale vlerësonte se 400,000 armë të vogla ishin në posedim ilegal në Kosovë. ‘Është vështirë të gjykohet se sa këto deklarata përfaqësojnë propagandë politike dhe jo të vërtetën,’ autorët e studimit të vitit 2003 i paralajmërojnë lexuesit e tyre.

⁴⁹ Kosova dhe Revolja: vlerësim bazik i armëve të shkurta dhe armëve të lehta në Kosovë, studim i autorizuar nga UNDP-ja, Qershor 2003, pg.32

⁵⁰ Kosova dhe Revolja: vlerësim bazik i armëve të shkurta dhe armëve të lehta në Kosovë, studim i autorizuar nga UNDP-ja, Qershor 2003, pg.17

⁵¹ Kosova dhe Revolja: vlerësim bazik i armëve të shkurta dhe armëve të lehta në Kosovë, studim i autorizuar nga UNDP-ja, Qershor 2003, pg.33

⁵² UNODC, 2008

⁵³ Elaboruar nga Studimi për Armët e Shkurta 2007 dhe SEESAC 2006, UNODC, f.16

⁵⁴ Gorjanc, 2000, i cituar në Kosova dhe Revolja: vlerësim bazik i armëve të shkurta dhe armëve të lehta në Kosovë, studim i autorizuar nga UNDP-ja

Duket se paragjykimet në mesin e ndërkombëtarëve që punojnë në Kosovë kanë luajtur rol në rritjen e vlerësimeve për armët ilegale. Vet studimi i UNDP-së aludon në këtë drejtim. ‘Në mesin e stafit të huaj që punon në Kosovë, përmendja e kulturës shqiptare të armëve dhe më specifikisht përmendja e *Kanunit* përdoren shpesh për ta shpjeguar (keq)përdorimin e lidhjes së shqiptarëve të Kosovës me armë,’ thuhet në studim.⁵⁵ Kjo është njësoj si të provojmë t’ia shpjegojmë dikujt kulturën gjermane duke e përmendur *Nibelungenlied* apo ti këshillojmë vizitorët ta lexojnë veprën *Canterbury Tales* të Geoffrey Chaucer për ta kuptuar shoqërinë bashkëkohore britanike.

KËRCËNIMI SHQIPTAR

‘Ajo është Kolumbia e Evropës,’ Marko Nicoviq, nënkryetari i shoqatës ndërkombëtare të zyrtarëve kundër narkotikëve, tha në një intervistë për *The Guardian* në vitin 2000. ‘Kur policia serbe digjte shtëpi në Kosovë, ata gjenin heroinë të fshehur në kulm.’ Artikulli në *The Guardian* pohonte që Kosova furnizon ‘deri në 40 përqind të heroinës që shitet në Evropë dhe në Amerikën Veriore.’⁵⁶ Nicoviq dikur kishte qenë shef i forcës jugosllave kundër narkotikëve; saktësia e deklaratës kurrë nuk ishte vënë në pyetje.

Rreth 100 tonë heroinë kalon çdo vit nëpër Evropën Juglindore, dhe vlera e saj në treg është US\$ 25-30 miliardë.⁵⁷ Trafikimi i narkotikëve është burim i rëndësishëm financiar për krimin e organizuar në Ballkan. Për dekada më radhë, ‘rruga e Ballkanit’ ka qenë rruga kryesore për furnizimin e Evropës me heroinë. Pjesa më e madhe e heroinës besohet të kalojë nëpër Bullgari.

Gjeografikisht, Kosova gjendet në të ashtuquajturën ‘rruga e drogës në Ballkan’ që e lidh Afganistanin, ku prodhohet 90 përqind e heroinës në botë, me Evropën Perëndimore, tregun më fitimprurës. Janë tri rrugë kryesore që kalojnë nëpër Ballkan; rruga veriore kalon nëpër Bullgari, Rumani, Hungari apo Ukrainë, Sllovakia apo Poloni, dhe Austria e Gjermania janë destinacionet finale. Rruga qendrore kalon nga Bullgaria në Maqedonia ose Serbi, nëpërmjet Bosnjës e Hercegovinës, në Kroaci, kalon nëpër Slloveni dhe përfundon në Itali. Rruga jugore nis nga Bullgaria në Maqedoni ose Kosovë, dhe vazhdon nëpërmjet Shqipërisë deri në Itali. Është fakt i thjeshtë gjeografik që Kosovë gjendet në rrugën tranzit të heroinës, por kjo vlen edhe për Bullgarinë dhe Austrinë, dy vende anëtare të BE-së, dhe Turqinë, vend kandidat për anëtarësim në BE.

Në vitin 2000, Zëvendës Drejtori i Interpolit dëshmoi para Kongresit Amerikan që rrjetet shqiptare kontrollojnë rreth 70 përqind të tregut të heroinës në Zvicër, Gjermani, Austri

⁵⁵ Kosova dhe Revolja: vlerësim themelor për armët e shkurta dhe të lehta në Kosovë, studim i autorizuar nga UNDP, qershor 2003, f.31.

⁵⁶ The Guardian. Furnizimi me heroinë i Evropës nga mafia kosovare e drogës. Mars 13, 2000.

⁵⁷ Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan dhe vendet e ndikuara, Zyra e OKB-së për Drogë dhe Krim, Mars 2008, f.59

dhe në vendet skandinave. Baza e këtij pohimi mbetet e paqartë; por pasqyron një mendim shumë të përhapur që bandat kriminele shqiptare e kontrollojnë furnizimin e Evropës me heroinë. Pohohej që në vitet e 90-ta, shqiptarët i kishin zëvendësuar rrjetet turke që dikur dominonin në tregjet evropiane të heroinës. Luftrat në Jugosllavi, kolapsi shtetëror në Shqipëri dhe fakti që Shqipëria është shumë afër Italisë me det, ndihmuan në përforsimin e përparësisë së grupeve kriminele shqiptare.

Raportet ndërkombëtare për trafikimin etnik të drogës nga shqiptarët harrojnë të përmendin faktin që kanë përfunduar luftrat në Jugosllavi, që nuk ka më embargo ekonomike, që nuk ka më paramilitarë që udhëheqin kartelet dhe unaza të kontrabandit dhe që Shqipëria në ndërkohë ka marrë ftesën për tu anëtarësuar në NATO. Tash e disa vite, mendimi që shqiptarët e kontrollojnë trafikimin e heroinës është shndërruar në mendim të përgjithshëm për Ballkanin.

Një raport i fundit i Kombeve të Bashkuara i botuar nga Zyra për Drogë dhe Krime i përshkruan ‘dilerët shqiptarë të heroinës si fenomenin më të njohur të krimit të organizuar në Ballkan.’⁵⁸ Këshilli i Evropës, në raportin e vitit 2005 mbi Krimin e Organizuar paralajmëronte që ‘grupet kriminale etnike shqiptare i paraqesin kërcënim të madh BE-së për shkak të involvimit të tyre në trafikimin e drogës.’⁵⁹ ‘Grupet Kriminale Etnike Shqiptare’ janë poashtu grupi i vetëm kombëtar që diskutohet në botimin e Europolit të vitit 2006.

Kur IKS vendosi ta vërtetoj këtë pohim zbuluam që imazhi i mafiasë shqiptare të drogës të organizuar mirë dhe brutale dhe kontrolli i saj mbi rrugët e drogës në Ballkan nuk konfirmohet me të dhënat zyrtare për konfiskimin e drogës dhe arrestimeve në vendet kyçe të destinimit. Në Zvicër, shqiptarët më së shpeshti fajësoheshin për trafikimin e 70-90 përqind të heroinës. Në vitin 2006, sipas të dhënave të Policisë Federale Zvicrane, vetëm 34 përqind të arrestimeve të heroinës përfshinin një shqiptar (në shumicën e rasteve shitës të vogël të drogës!) dhe vetëm një jugosllav është arrestuar për kontrabandë.⁶⁰

Një trend i ngjashëm është vërejtur në Itali ku autoritetet kombëtare në vitin 2005 raportuan që ‘40 përqind e heroinës kontrollohet nga shqiptarët’ dhe vetëm një vit më vonë, më 2006, autoritetet pohonin që ‘80 përqind e tregtisë me heroinë kontrollohet nga shqiptarët.’⁶¹ Diskrepanca në mes 40 dhe 80 përqind nuk është shpjeguar kurrë. Por në fakt, vetëm 6 përqind të arrestimeve për trafikim të heroinës në vitin 2006 përfshinin shqiptarë etnik, përderisa 65 përqind ishin italianë dhe 19 përqind ishin nga Afrika Veriore.

⁵⁸ Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan dhe vendet e ndikuara, Zyra e OKB-së për Drogë dhe Krim, Mars 2008, f.65

⁵⁹ Azhurnim i Raportit të Gjendjes 2005 mbi Krimin e Organizuar dhe Ekonomik në EJK, Këshilli i Evropës

⁶⁰ Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan dhe vendet e ndikuara, Zyra e OKB-së për Drogë dhe Krim, Mars 2008, f.68

⁶¹ Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan dhe vendet e ndikuara, Zyra e OKB-së për Drogë dhe Krim, Mars 2008, f.66

As Austria nuk është përjashtim në këtë rast; autoritetet austriake raportuan që ‘grupet kriminale të shqiptarëve etnik vazhdojnë të jenë përgjegjëse për transportimin e heroinës... në shumicën e rasteve nga Kosova në Austri.’ Megjithatë, vetëm tri prej 660 të arrestuarve për heroinë ishin shqiptarë dhe që nga viti 2001 kurrë nuk janë arrestuar më tepër se 3 shqiptarë në vit për akuza të ndërlidhura me drogë.⁶² Në Gjermani, gjatë 7,819 konfiskimeve të heroinës në vitin 2006 u arrestuan vetëm 15 shqiptarë dhe 164 ‘jugosllav.’ Sasia e drogës ishte 12 kg prej sasisë së përgjithshme të 879 kg të heroinës së konfiskuar.⁶³

Edhe në vendet siç janë Sllovenia dhe Hungaria, ku nuk ka komunitete të diasporës shqiptare, mbretëron perceptimi negativ për dilerët shqiptarë të drogës. Vlerësimi kombëtar i krimit në Slloveni, i cili iu dorëzua Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Kontroll të Drogës dhe Krimit, thotë që ‘grupet e organizuara kriminale të shqiptarëve etnik duket të jenë problemi më i madh.’ Kjo është befasuese duke marrë parasysh se asnjë shqiptar i vetëm nuk është arrestuar gjatë 51 arrestimeve për trafikim të narkotikëve. Në mesin e të arrestuarve vetëm 2 përqind ishin jugosllav – përsëri mendimi që shqiptarët dhe pjesëtarët tjerë të grupeve etnike që jetojnë në Kosovë, Mal të Zi dhe Serbia posedojnë pasaportat valide jugosllave.⁶⁴ Në Hungari, autoritetet deklaruan se ‘grupet shqiptare akoma kanë rol udhëheqës në trafikimin ilegal të narkotikëve.’⁶⁵ Megjithatë, asnjë shqiptarë nuk është arrestuar në Hungari në vitet 2005 dhe 2006.

Ti lëmë perceptimet dhe paragjykimet anash, dhe cila është e vërteta mbi rolin e shqiptarëve etnik në trafikimin e drogës? Një studim mbi trafikimin e drogës i kryer në vitin 2004 në 15 vende kyçe evropiane arriti në përfundim që më së shumti 6 përqind e trafikantëve të arrestuar të drogës ishin ‘shqiptarë etnik’ – një term i cili përfshin shqiptarët nga Shqipëria dhe shqiptarët nga Kosova dhe tjerët që jetojnë jashtë shtetit të Shqipërisë. Etiketimi ‘krimi etnik shqiptar’ nuk bën dallime në mes shtetësive.

Studimi i vitit 2004 vlerësonte se ishin bërë 18,749 arrestime për trafikim të drogës në tregjet e mëdha të drogës përfshirë këtu Italinë, Gjermaninë dhe Holandën. Studimi poashtu tregonte se 62 përqind të të arrestuarve për trafikim të heroinës ishin nga Evropa Perëndimore; 2 përqind ishin serb/malazez/maqedonas; 4 përqind ishin shqiptarë; 4 përqind ishin turq; 10 përqind ishin afrikanë dhe 12 përqind ishin të tjerë.⁶⁶ Duke supozuar se të gjithë trafikantët që vijnë nga Serbia, Mali i Zi apo Maqedonia janë me gjasë shqiptarë etnik, 6 përqind të trafikantëve të arrestuar të drogës janë ‘shqiptarë etnik.’ Ky numër është shumë larg imazhit të perceptuar për kontrollimin e tregjeve të Evropës Perëndimore nga ‘mafia shqiptare e drogës.’

⁶² Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan dhe vendet e ndikuara, Zyra e OKB-së për Drogë dhe Krim, Mars 2008, f.70

⁶³ *Ibid*, f.69

⁶⁴ *Ibid*, f.71

⁶⁵ *Ibid*, f.71

⁶⁶ *Ibid*, f.72

Kjo vë në dyshim shumë ‘vlerësime zyrtare’ të agjencive evropiane për zbatimin e ligjit të cilat shfaqin tendenca ta konfirmojnë imazhin e ‘kërcënimit shqiptar.’ Duket se ekziston një zbrazëti e madhe në mes perceptimit dhe realitetit.

Kjo megjithatë nuk është arsytim që autoritetet kosovare të jenë të buta në përgjigjet e tyre ndaj trafikimit të narkotikëve dhe përdorimit lokal të drogës. Kosova akoma nuk ka strategji kombëtare për parandalimin e përdorimit të drogës. Për shkak të statusit të saj të kontestuar, Kosova nuk është pjesë e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Drogës, e vitit 1988. Raporti i fundit i Departamentit Amerikan të Shtetit për narkotikët përmend disa sfida me të cilat ballafaqohen zyrtarët kosovar kundër narkotikëve; ata nuk kanë pajisje dhe burime bazike, operacionet e fshehta ndërlikohen nga komunitetet e lidhura ngushtë shqiptare dhe çështjet teknike, si dhe nga operatori ilegal i telefonisë mobile serbe që është jashtë kontrollit të Shërbimit Policor të Kosovës.⁶⁷

Megjithatë, ka edhe progres. Në maj të vitit 2006, përgjegjësia për hetimin e trafikimit të narkotikëve i është kaluar Shërbimit Policor të Kosovës. Që atëherë, shkalla e konfiskimit të drogës ka shënuar rritje.⁶⁸ Në vitin 2006, Shërbimi Policor i Kosovës shkatërroi 75,800 bimë të kanabisit krahasuar me 8,000 bimë të shkatërruara në vitin 2004 kur kjo kompetencë ishte në duart e UNMIK-ut.

Sasia e drogës së konfiskuar në kilogram në vit**:

Viti	Heroinë	Kokainë	Marihuanë
2001	0.81	0.034	30.71
2002	6.10	1.40	48.04
2003	46.78	8.48	30.81
2004	23.28	0.010	23.28
2005	36.47	3.78	55.30
2006	14.64	1.72	66.63
2007	47.76	1.92	32.12
Total	175.84	17.34	286.89

Burimi: Raporti i Shërbimit Policor të Kosovës për drogat e konfiskuara

Policia e Kosovës është përmirësuar në ndërtimin e rasteve dhe në sjelljen e autorëve të krimit para gjyqit. Rritja e qëndrueshme e konfiskimit të heroinës në Kosovë u shoqërua me numër të shtuar të rasteve që hetuesit i përfunduan dhe i dorëzuan në gjykatë.⁶⁹

Viti	Heroina e Konfiskuar	Rastet
------	----------------------	--------

⁶⁷ Strategjia Ndërkombëtare e Departamentit Amerikan të Shtetit për Kontrollin e Narkotikëve, 2008

⁶⁸ Strategjia Ndërkombëtare e Departamentit Amerikan të Shtetit për Kontrollin e Narkotikëve, 2008

⁶⁹ Të dhënat e Shërbimit Policor të Kosovës. Vetëm në vitin 2007, policia ka regjistruar 528 të dyshuar, prej të cilëve 197 u arrestuan, derisa të dyshuarit e tjerë kanë kaluar në procedurën e rregullt. Sipas përkatësisë etnike, në vitin 2007, 95% të dyshuarve në arrestime e ndërlidhura me drogë ishin shqiptarë, 4% serbë dhe 1% të tjerë. Prej numrit të përgjithshëm të të dyshuarve, 538, 96% (516) ishin meshkuj dhe 4% (22) ishin femra.

2001	0.8 kg	N/A
2002	6.1 kg	N/A
2003	46.7 kg	N/A
2004	23.2 kg	213
2005	36 kg	232
2006	14.6 kg	284
2007	47.8 kg	306

Në prag të pavarësisë, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin e ri për prodhimin, eksportin dhe importin e narkotikëve. Ligji parasheh krijimin e komisionit për hartimin e strategjisë kundër narkotikëve. Mbetet të shihet se çka do të sjell e ardhmja.

PERCEPTIMI DHE REALITETI

Në vitin 2007, Transparency International e renditi Kosovën si vendin e katërt më të korruptuar në botë. Sipas Barometrit të Korrupsionit Global të Transparency International, 67 përqind e 500 të anketuarve pohojnë që kanë paguar ryshfet për shërbime publike.⁷⁰ Kjo e vendos Kosovë në pikën më të ulët. Vetëm tri vende qëndrojnë më keq; në Kamerun, 79 përqind e respondentëve pohojnë që kanë paguar ryshfet, në Kamboxhia 72 përqind dhe në Shqipëri 71 përqind. Ky është konkludim shkatërrues dhe duket se konfirmon paragjykimet ekzistuese për animin e klasës politike kosovare kah korrupsioni, për institucionet e saj të dobëta dhe për përpjekjet gjysmë të sinqerta për luftimin e korrupsionit.

Ajo që shumë njerëz kishin harruar ishte fakti që institucioni i njejtë, vetëm një vit më herët, kishte gjetur se vetëm 12 përqind të qytetarëve të hulumtuar kishin paguar ryshfet në Kosovë. Barometri i Korrupsionit Global të Transparency International në vitin 2006 e renditi Kosovën në mesin e vendeve siç janë Bullgaria, Luksemburgu, Kroacia dhe Hong Kongu.⁷¹ Transparency International kurrë nuk e shpjegoi mospërputhjen e madhe që e zbuluan anketimeve e veta. Mediat lokale dhe ndërkombëtare ishin të gëzuara të raportojnë një titull kaq bombastik dhe ‘imazhi negativ’ i Kosovës si vendi i katërt më i korruptuar në botë u vulos në gurë.

Në përpjekje për të hedhur dritë mbi paradoksin e korrupsionit në Kosovë, ne krahasuam studimet e ndryshme ndërkombëtare të institucioneve të respektuara dhe ekspertëve të korrupsionit. Korrupsioni zakonisht matet me anë të hulumtimeve me qytetarë, por rezultatet dallojnë shumë. Hulumtime të ndryshme të kryera në mes viteve 2001 dhe 2007 e kanë renditur Kosovën në fillim në mesin e vendeve më të suksesshme dhe pastaj në pikë të fundit.

⁷⁰ ‘Raporti i Barometrit të Korrupsionit Global i Transparency International 2007,’ botuar nga Transparency International – 6 dhjetor 2007

⁷¹ ‘Raporti i Barometrit të Korrupsionit Global i Transparency International 2007,’ botuar nga Transparency International, 2006

Një studim i financuar nga USAID në vitin 2003, Kosova renditej në vendin e parë në mesin e 9 vendeve të rajonit. Autorët konkluduan që ‘korrupsioni nuk duket se është edhe aq i përhapur në mesin e zyrtarëve publik, kërkesat për sjelljet fitimprurëse të zyrtarëve publik janë më të ulëta dhe shkalla e përfshirjes së qytetarëve në transaksionet korruptive është më e ulët se në vendet fqinje.’⁷²

Një studim përmbajtësor për korrupsionin i financuar nga UNDP-ja në vitin 2004 zbuloi diskrepancë të jashtëzakonshme në mes perceptimit dhe përvojës aktuale të korrupsionit. Sipas këtij studimi, vetëm 15 përqind të të anketuarve e mbështesin vlerësimin e tyre për korrupsion në institucionet publike mbi bazat e përvojave personale.⁷³

Institucionet	Perceptimi	Përvoja
Qeveria Qendrore	43 %	11 %
Doganat	66 %	17 %
KEK-u	76.3 %	17 %

*UNDP intervistoi 1,136 kosovarë për perceptimin dhe përvojën me korrupsion*⁷⁴

Për ta matur rëndësinë e korrupsionit për publikun në Kosovë, ne poashtu konsultuam Raportet e Paralajmërimit të Hershëm të UNDP-së, që botoheshin rregullisht që nga viti 2001. Gjatë këtyre viteve, në pyetjen se cili është problemi më i madh në Kosovë, mesatarisht vetëm 5 përqind të të anketuarve e përmendin korrupsionin si problemin kryesor. Tri problemet kryesore në maje të listës ishin statusi final (40 përqind), papunësia (26 përqind) dhe varfëria (15 përqind).⁷⁵ Poashtu në çerekun e parë të vitit 2008, vetëm 2.4 përqind të respondentëve konsideronin që korrupsioni është problem i rëndësishëm, derisa 32 përqind brengosen për statusin përfundimtar, për papunësinë 17 përqind dhe 13 përqind për varfërinë.⁷⁶

Këto vlerësime më të nuancuara për nivelin e korrupsionit nuk kanë shumë gjasa kundër makinerisë për marrëdhënie me publikun të Transparency International. Sapo të bëhet publik pohimi që Kosova është vendi i katërt më i korruptuar në botë, është shumë vështirë të korrigjohet ky pohim. Posaçërisht nëse organizatat serioze ndërkombëtare siç është Banka Botërore thjeshtë i kopjojnë dhe i marrin si të gatshme këto pohime.

Në vitin 2006, Banka Botërore botoi një raport të gjerë për renditjen e 212 vendeve në fushën e qeverisjes së mirë. Për qëllime të studimit, qeverisja e definua si ‘traditat dhe institucionet me anë të cilave ushtrohet pushteti në një vend.’ Rënditja Globale u bë në

⁷² MSI Corruption Survey. USAID, Maj 2003. Studimi përfshiu 505 të anketuar si dhe intervista me stafin e qeverisë, përfaqësues të mediave, shoqërisë civile, donatorë dhe afaristë.

⁷³ UNDP., Luftimi i Korrupsionit në Kosovë: Studim mbi perceptimin e qytetarëve në përkrahje të Strategjisë Kosovare Kundër Korrupsionit, prill 2004

⁷⁴ UNDP. Luftimi i Korrupsionit: Studim mbi perceptimin e qytetarëve në përkrahje të Strategjisë Kosovare Kundër Korrupsionit, prill 2004.

⁷⁵ Raporti i Paralajmërimit të Hershëm, 2001- 2008

⁷⁶ Raporti i Paralajmërimit të Hershëm, 2008, Cereku I

bazë të gjashtë komponentëve, përfshirë këtu lirinë e shprehjes dhe përgjegjshmërinë, stabilitetin politik, efikasitetin e qeverisjes, cilësinë e rregulluar, sundimin e ligjit dhe kontrollimin e korrupsionit.

Kosova renditet shumë keq në të gjitha këto fusha; dhe ka notat më të ulëta prej të gjitha vendeve të Evropës Lindore dhe Baltikut; dhe renditet në vend të fundit nëse shikohen indikatorët individual – sundimi i ligjit apo kontrollimi i korrupsionit – në krahasim me fqinjët e saj në Evropën Juglindore.

Indikatorët e Bankës Botërore për Qeverisje 2007⁷⁷

Indikator i Qeverisjes	Mesatarja në Kosovë	Mesatarja në rajon	# i burimeve
Zëri & Përgjegjshmëria	26.9%	64%	4*
Stabiliteti Politik	Nuk ka të dhëna	55.1%	0
Efikasiteti i qeverisjes	44.5%	62%	1**
Cilësia e Rregulluar	Nuk ka të dhëna	68.1%	0
Sundimi i Ligjit	22.9%	54.4%	2***
Kontrollimi i Korrupsionit	25.6%	56.9%	3****

*Freedom House, Gallup World Poll, International Research and Exchanges Board Media Sustainability Index, Reporters Without Borders Press Freedom Index

**Gallup World Poll

***Freedom House, Gallup World Poll

****Studimi i Barometrit të Korrupsionit Global të Transparency International

Kontrollimi i korrupsionit

Vendi	% Renditja	# i burimeve
Sllovenia	78.3%	13
Sllovakia	65.2%	13
Kroacia	58.9%	14
Rumania	55.6%	17
Bullgaria	53.1%	16
Maqedonia	50.7%	12**
Serbia	46.4%	13
Bosnja dhe Hercegovina	44.9%	13
Mali i Zi	44.4%	8
Shqipëria	36.7%	12
Kosova	25.6%	3*

*Burimet për Kosovën: Freedom House, Gallup World Poll & Transparency International Global Corruption Barometer Survey

** Burimet për Maqedoninë: Bertelsmann Transformation Index, Business Enterprise Environment Survey, Economist Intelligence Unit, Freedom House, Gallup World Poll, Global Insight Business Conditions and Risk Indicators, Global Insight Global Risk Service, IFAD Rural Sector Performance Assessments, Merchant International Group Gray Area Dynamics, Transparency International Global Corruption

⁷⁷ www.govindicators.org

Sundimi i Ligjit

Vendi	% Renditja	# i burimeve
Sllovenia	75.1%	16
Sllovakia	60.5%	16
Kroacia	55.2%	16
Bullgaria	51.4%	18
Rumania	50.5%	19
Mali i Zi	48.1%	10
Maqedonia	41.4%	14
Bosnja dhe Hercegovina	39.5%	15
Serbia	34.8%	14
Mali i Zi	28.1%	14
Kosova	22.9%	2*

*Freedom House & Gallup World Poll

Kur i analizuar të dhënat më me kujdes zbuluar se vlerësimi i Bankës Botërore për një fenomen aq kompleks siç është qeverisja e mirë në Kosovë bazohet vetëm në dy burime. Vendet e tjera të rajonit, që renditen më lart se Kosova, vlerësohen në bazë të 14 deri 19 burimeve të ndryshme. Kosova dallohet me numër jashtëzakonisht të vogël të burimeve, dhe mungesa e habitshme e të dhënave krahasuese shkon në dëm të Kosovës.

Vendet	Kontrollimi i Korrupsionit	Sundimi i Ligjit	Burimet
Sllovenia	78 %	75 %	16
Sllovakia	65 %	61 %	16
Kroacia	59 %	55 %	16
Rumania	56 %	50.5 %	19
Bullgaria	53 %	51.4 %	18
Maqedonia	51 %	41 %	14
Serbia	46 %	35 %	14
Bosnja dhe Hercegovina	45 %	40 %	15
Mali i Zi	44 %	48 %	10
Shqipëria	37 %	28 %	14
Kosova	26 %	23 %	2*

Burimet për Kosovën: Freedom House dhe Gallup World Poll

Dy burimet në të cilat Banka Botërore e mbështet renditjen e saj ishin Freedom House dhe Gallup World Poll. Studimi *Liria në Botë* sjell vlerësim vjetor për gjendjen e lirisë globale në 193 vende dhe 15 territore të zgjedhura. Liria matet në bazë të drejtave politike dhe lirive civile. Zbulimet e studimit bazohen në analizat dhe vlerësimet e ekipit të ekspertëve dhe studiuesve rajonal. Çdo vend renditet në shkallën prej 1 deri në 7; 1

është shkalla më e lartë e lirisë dhe 7 shkalla më e ulët e lirisë. Në bazë të këtyre vlerësimeve, një vend klasifikohet si i Lirë, Pjesërisht i Lirë, apo Jo i Lirë.

Sipas raportit të vitit 2007, Kosova klasifikohet si ‘Jo e Lirë’ dhe morri notat 6 për të drejtat politike dhe 5 për liritë civile. Kështu, Kosova renditet në pozitë të njëjtë me Sudanin, Çadin dhe Egjiptin sa i përket të drejtave politike dhe liritë civile. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë UNMIK-u duhet të ketë dështuar jashtëzakonisht keq në përpjekjet për vendosjen e standardeve demokratike dhe drejtave të njeriut. Kjo renditje në mënyrë të jashtëzakonshme e injoron faktin që Kosova në fakt ka zgjedhje të lira dhe korrekte, liri të shtypit dhe prezencën ushtarake të NATO-së. Ky është dallim i madh prej diktaturës së Sudanit, dhunës së vazhdueshme në Çad dhe kontrollin e përhershëm të ushtrisë mbi pushtetin në Egjipt.

Freedom House 2007*

Vendet	Statusi	Të Drejtat Politike	Të Drejtat Civile
Sudani	Jo i Lirë	7	7
CCadi	Jo i Lirë	6	6
Kosova	Jo i Lirë	6	5
Egjipti	Jo i Lirë	6	5
Omani	Jo i Lirë	6	5
Maqedonia	Pjesërisht e Lirë	3	3
BeH	Pjesërisht e Lirë	3	3
Serbia	E Lirë	3	2
Zvicra	E Lirë	1	1

*Renditjet e Freedom House bazohen në shkallën prej 1 deri në 7, ku 1 është shkalla më e lartë dhe 7 është shkalla më e ulët e progresit demokratik

Burimi i dytë i Bankës Botërore është Gallup International. Në vitin 2007, Gallup i pyeti 1,000 të anketuar në Kosovë nëse besojnë që ‘korrupsioni është shumë i përhapur’ në qeveri dhe biznes. Ky hulumtim nuk bën dallim në mes të perceptimit qytetar të korrupsionit dhe përvojës aktuale të korrupsionit. Sipas Gallup, Sllovakia vuan shumë më tepër nga korrupsioni në qeveri se Kosova, përderisa bizneset në Rumani duket se janë shumë të prirur për korrupsion. As Sllovenia nuk qëndron më mirë në këtë drejtim.

Gallup International 2007 *

A është korrupsioni shumë i përhapur në ...?

Vendi	Qeveri	Biznes
Mali i Zi	66	49
Shqipëria	68	73
Sllovenia	69	43
Kosova	72	84
Sllovakia	82	84
Serbia	82	71
Kroacia	83	77
Rumania	83	86
Maqedonia	86	74
Bosnja	86	81

Në takimin e parë të qeverisë më 11 janar 2008, Kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi u zotua për “zero tolerancë” ndaj korrupsionit dhe e paralajmëroi kabinetin e tij: ‘Ne do të jemi të kujdesshëm në mënyrën si e përdorim buxhetin e vendit tonë, duke dhënë shpjegime për çdo cent të shpenzuar... Si Kryeministër unë do ta ndëshkoj keqmenaxhimin dhe keqpërdorimin e buxhetit dhe këto dy fenomene do të ndiqen me ligj.’⁷⁸ Mirëpo, kjo është më lehtë të thuhet sesa të bëhet.

Shumica e institucioneve kosovare për luftimin e korrupsionit janë themeluar rishtazi, dhe ballafaqohen me sfidat që kanë të gjitha institucionet – pagat e ulëta, mungesa e përvojës dhe mandati i paqartë. Masat e para anti-korrupsion u ndërmorën si rezultat i presionit ndërkombëtar, më saktësisht nga procesi i Kombeve të Bashkuara për “Standardet para Statusit.” Njeri prej standardeve që Kosova duhej ta përmbushte ishte themelimi i agjencisë anti-korrupsion dhe miratimi i ligjit për shtypjen e korrupsionit. Që atëherë, Kosova ka shënuar progres të matur me ndërtimin e mjeteve dhe institucioneve për çrrënjosjen e korrupsionit.

Tetor 2002	U themelua Zyra e Auditorit Gjeneral
Shkurt 2003	U themelua Njësia për Inspektime Financiare (Guardia di Finanza)
Dhjetor 2003	U themelua Grupi Punues Ndërmintor Anti-Korrupsion
Mars 2004	“Luftimi i korrupsionit” u përfshi në Standardet për Kosovën
Mars 2004	U promovua Strategjia Anti-Korrupsion
Maj 2005	Kuvendi miratoi Ligjin për Shtypjen e Korrupsionit
Fillimi i 2006	Plani i Veprimt Anti-Korrupsion
Prill 2006	U themelua Këshilli i Agjencisë Anti-Korrupsion (KAA)
Korrik 2006	U emërua Drejtori i KAA-së
Qershor 2007	Ligji për Auditim të Brendshëm
Korrik 2007	U rishikua Ligji për Prokurim Publik

⁷⁸ Kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi. Fjalimi me rastin e krijimit të Qeverisë së Kosovës. 11 janar 2008.

Agjencioni Anti-Korrupsion ka 30 kuadro dhe buxhet vjetor prej 456,000 Euro, që është ekuivalenti i 0.04 përqind të buxhetit të Kosovës.⁷⁹ Ndër hapat e parë, Agjencioni vendosi një linjë telefonike pa pagesë ku qytetarët mund të raportojnë në mënyrë të fshehtë për rastet e korrupsionit. Agjencioni tashmë ka dorëzuar 47 raste në zyrën e prokurorit. Në vitin 2007, hetimet e Agjencionit shpëtuan 7 milion euro të buxhetit të Kosovës. Në gjashtë muajt e parë të vitit 2008, agjencioni raportoi 68 raste të korrupsionit të supozuar, dhe 21 prej tyre u dërguan në zyrën e prokurorit. Llogaritet që buxheti i Kosovës të jetë dëmtuar për rreth 6 milion euro.⁸⁰ Ka brenga që agjencioni anti-korrupsion është organizatë politike, dhe që deri më tani ka pasur ndikim të kufizuar.⁸¹ Është tepër herët të shpallet fitorja, por fakti që Agjencioni Anti-Korrupsion po funksionon paraqet hap të rëndësishëm në drejtimin e duhur.

Për të qenë të suksesshme në luftën kundër korrupsionit, autoritetet kosovare duhet të nisin një mision të madh të ‘zbulimit të fakteve’ dhe të gjenerojnë fakte, statistika dhe të dhëna krahasuese që do të mundësonin një vlerësim real të korrupsionit. Pa e njohur më mirë gjendjen në terren, është thuajse e pamundur të matet puna e institucioneve publike në luftimin e korrupsionit. Siç kemi thënë edhe më lart, mungesa e studimeve, anketimeve dhe kërkimeve të hollësishme vetëm sa ndihmon në forcimin e imazhit negativ të Kosovës.

THEMBRA E AKILIT E KOSOVËS

Krimet ndëretnike deri më sot janë njëra prej çështjeve më të ndjeshme në Kosovën e pasluftës. Mbrojtja e komuniteteve pakicë në Kosovë, posaçërisht të serbëve që përbëjnë rreth 7 përqind të popullsisë, është bërë (*raison d'être*) arsyeja e vetme e ekzistencës për UNMIK-un. Njohja ndërkombëtare e pavarësisë është kusht që institucionet kosovare ti qëndrojnë besnike përkushtimit për ndërtimin e shoqërisë multietnike. Për shkak të rëndësisë së krimeve ndëretnike dhe marrëdhënieve ndëretnike, është për tu befasuar se sa pak dimë ne.

Ka shumë spekulime, por në fakt nuk ka statistika të besueshme për krimet ndëretnike. Është jashtëzakonisht vështirë të bëhet dallimi në mes krimeve si të tilla dhe krimeve të movituara etnikisht. Statistikat e krimeve nuk specifikojnë përkatësinë etnike të viktimës dhe të autorit të krimit; ne nuk e dimë nëse një serb është vrarë nga një shqiptarë apo nga një serb tjetër. Statistikat poashtu nuk specifikojnë motivet e krimit; nëse një vrasje është vërtetë e motivuar etnikisht apo është pasojë e ndonjë mosmarrëveshjeje personale, xhelozisë apo arsyeve ekonomike. Ç’është edhe më befasuese, edhe të dhënat e ofruara nga UNMIK-u tregojnë mospërputhje të jashtëzakonshme.

⁷⁹ Intervistat e IKS me zyrtar të lartë të Agjencionit Anti-Korrupsion; Prishtinë, qershor 2008

⁸⁰ Intervistat e IKS me zyrtar të lartë të Agjencionit Anti-Korrupsion; Prishtinë, qershor 2008

⁸¹ Përbërja aktuale e Bordit të Agjencionit Anti-Korrupsion parashihet tre përfaqësues nga kuvendi, një nga zyra e presidentit, dhe nga një përfaqësues të qeverisë, gjykatës supreme, zyrës së prokurorit ublik, autoriteteve lokale dhe shoqërisë civile.

Për shkak të natyrës së veçantë të vrasjes, të paktën statistikat e vrasjeve janë të besueshme në shumicën e vendeve – përveç në Kosovën e administruar nga OKB-ja. Sipas të dhënave nga policia e UNMIK-ut, të klasifikuara sipas përkatësisë etnike të viktimave, gjatë periudhës 2000-2006 kanë ndodhur 882 vrasje. Numri i përgjithshëm i vrasjeve sipas policisë së UNMIK-ut gjatë periudhës së njejtë, por jo i klasifikuar sipas përkatësisë etnike, është 770 – dallim i madh prej 112 vrasjesh. Si është e mundur kjo?⁸² A e ka rritur UNMIK-u qëllimisht shkallën e vrasjeve të klasifikuar sipas përkatësisë etnike? Apo ndoshta është vetëm gabim i paqëllimshëm të cilin nuk e kanë vërejtur komisionerët e ardhshëm të policisë?

Kundërthënie ka edhe në mes të dhënave të UNMIK-ut dhe atyre të Policisë së Kosovës; sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, në vitin 2000 për shembull, kishin ndodhur 226 vrasje. Sipas Policisë së UNMIK-ut për Analizimin e Krimeve dhe Informatave Operative, numri i përgjithshëm i vrasjeve në vitin 2000 ishte 267 – përsëri një dallim i madh prej 41 vrasjesh.

Vrasjet	Shqiptarë	Serb	Të Tjerë	Total*	Të dhënat e SHPK-së**	Policia e UNMIK-ut***
2000	187	56	24	267	226	267
2001	138	23	15	176	185	185
2002	93	8	7	108	88	88
2003	85	18	10	113	70	70
2004	79	11	5	95	78	75
2005	56	3	3	62	67	68
2006	52	6	3	61	61	58
	690	125	67	882	775	770

* Qendra Operacionale Kryesore e Policisë së UNMIK-ut, Analizimi i Krimeve & Informatave Operacionale, Aktivitetet Vjetore të Krimit sipas përkatësisë etnike të viktimave

** Shërbimi Policor i Kosovës, Drejtorati për Analizim të Krimit, Zyra e Statistikave, Raporti Vjetor i Krimit

*** Analizimi i Krimeve & Informatave Operacionale të Policisë së UNMIK-ut, Aktivitetet Vjetore të Krimit sipas përkatësisë etnike të viktimave

Përkundër këtyre mospërputhjeve, janë disa fakte që e dimë që janë të besueshme. Të gjitha të dhënat konfirmojnë që numri i vrasjeve ka shënuar rënie të jashtëzakonshme që nga viti 2000. Shkalla e vrasjeve ka rënë për dy të tretat, nga 226 vrasje në vitin 2000 në 65 vrasje në vitin 2007.⁸³ Poashtu dimë që sulmet me granata dhe eksploziv kanë rënë për 93 përqind prej vitit 2000 deri në 2007. Vjedhja e veturave ka rënë për 90 përqind gjatë periudhës së njejtë kohore. Këto përmirësime dramatike dëshmojnë se Kosova e pasluftës po kthehet në gjendje normale. Në vitin 2006, në Kosovë ndodhnin mesatarisht 3 vrasje

⁸² Analizimi i Krimeve & Informatave Operacionale të Policisë së UNMIK-ut, Aktivitetet Vjetore të Krimit sipas përkatësisë etnike të viktimave

⁸³ Shërbimi Policor i Kosovës, Drejtorati për Analizim të Krimit, Zyra e Statistikave, Raporti Vjetor i Krimit

për çdo 100,000 banorë krahasuar me 2.4 vrasje në Suedi, 4 për çdo 100,000 banorë në Bullgari dhe 5.5 vrasje në SHBA.

i vrasjeve për cdo 100,000 qytetarë

Shqipëria	179	5.68
SHBA	16,204	5.47
Bullgaria	240	4.1
Kosova	61	3.05
Suedia	215	2.38
Gjermania	809	0.98

Nëse i krahasojmë statistikën e krimeve të dhunshme në Kosovë me statistikën e Irlandës Veriore, shohim se Irlanda Veriore ka 960 më tepër incidencë.⁸⁴ Në fakt, në Kosovë ndodhin më pak vrasje, plaçkitje dhe vjedhje të makinave se në shumicën e vendeve të Evropës Perëndimore; Kosova më nuk është vend i dalë nga konflikti. Në përgjithësi, Kosova ka shkallë shumë të ulët të krimit, për 50 përqind më të ulët se mesatarja evropiane.⁸⁵

Kjo është e vërtetë për Evropën Juglindore në përgjithësi; edhe pse është befasuese, rajoni i Ballkanit është njeri prej rajoneve më të sigurta në Evropë. Nivelet e krimeve kundër njerëzve dhe pronës janë më të ulëta se në çdo vend tjetër në Evropë dhe numri i vrasjeve po shënon rënie në çdo vend të Ballkanit.⁸⁶ Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krim në raportin e fundit për kriminalitetin në Ballkan, konfirmon që pjesa më e madhe e rajonit është më e sigurt se Evropa Perëndimore. ‘Edhe nëse vetëm gjysma e vrasjeve në këto vende janë evidentuar,’ thuhet në raport, ‘ky numër megjithatë do të ishte i ulët sipas standardeve ndërkombëtare.’ Në Evropën Perëndimore, numri i vjedhjeve në shtëpi është dy herë më i madh, numri i sulmeve është katër herë më i madh dhe numri i plaçkitjeve është 15 herë më i madh se në Evropën Juglindore.⁸⁷

Sa i përket krimeve ndëretnike, ka dallime të mëdha në mënyrën se si komunitetet e ndryshme të Kosovës e perceptojnë sigurinë. Derisa shqiptarët më së shumti brengosën për papunësinë dhe varfërinë, 84 përqind të serbëve të Kosovës frikësohen se mund të bëhen viktima të krimit në të ardhmen.⁸⁸ Çdo i pesti serb i Kosovës e sheh dhunën etnike si rrezikun më të madh të sigurisë. Derisa shumica e serbëve bazohen në raportet e rrjeshme të mediave në Beograd për dhunë ndëretnike, dhe derisa policia nuk arrin të ofroj fakte dhe statistika të besueshme, rreziku do të mbretëroj. Nevojiten urgjentisht të

⁸⁴ Këto vlerësime bazohen në statistikën e krimit në vitin 2002, të cituara në Krimet e Motivuar Ekonomikisht në Kosovë – Raport Informues, 2004, Shtylla e BE-së e UNMIK-ut

⁸⁵ Qendra Informative për Krimin, UNMIK, cituar në Krimet e Motivuar Ekonomikisht në Kosovë – Raport Informues, 2004, Shtylla e BE-së e UNMIK-ut

⁸⁶ Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan dhe vendet e ndikuara, Zyra e OKB-së për Drogë dhe Krim, mars 2008, f.5

⁸⁷ Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan dhe vendet e ndikuara, Zyra e OKB-së për Drogë dhe Krim, mars 2008, f.9-10

⁸⁸ Rishikimi i Brendshëm i Sektorit të Sigurisë në Kosovë, UNDP, 2006

dhëna të besueshme dhe një strategji e komunikimit proaktiv për ta ulur frikën dhe tensionet.

BETEJA ME SFIDAT E VËRTETA

Në të gjitha vendet e tranzicionit dhe vendet e reja anëtare të BE-së, reformimi i gjyqësorit është dëshmuar njera prej detyrave më të vështira. Pikë së pari, BE-ja nuk ka një udhëzues të qartë për këtë, dhe e dyta, shumica e sistemeve gjyqësore vuajnë nga inercioni burokratik, mbikëqyrja e dobët, mungesa e përgjegjshmërisë dhe e nxitjes për reformë. Kosova nuk përbën përjashtim në këtë drejtim. Derisa shërbimi doganor dhe shërbimi policor i Kosovës janë ndërtuar nga zeroja pas luftës, gjyqësori u rikonfigurua pothuajse i paprekur, duke vazhduar me kuadro të vjetra dhe zakone të këqija. Vlerësimi i përgjithshëm është që përkundër të gjitha përpjekjeve, sistemi ligjor në Kosovë mbetet njera prej shtyllave më të dobëta të institucioneve publike të Kosovës.

Një raport i fundit i OSBE-së sjell një listë të gjatë të problemeve të pazgjidhura siç është shkelja e standardeve për gjykim korrekt, numrin në rritje e sipër të lëndëve të pazgjidhura gjyqësore dhe ndërhyrjen politike.⁸⁹ Human Rights Watch më herët këtë vit paralajmëroi ‘dështimin e autoriteteve që ti sjellin autorët e krimit para drejtësisë.’⁹⁰ Raporti i fundit i Komisionit Evropian poashtu thekson dobësinë e gjyqësorit dhe paralajmëron për ‘nivelin e ulët të besimit të popullsisë në sistemin e drejtësisë.’⁹¹

Gjatë nëntë viteve të kaluara nuk kanë munguar reformat. Një sasi e madhe e fondeve janë derdhur në trajnimin e sërishëm të gjykatësve, në riparimin e gjykatave, në hartimin e kodit të ri penal dhe në vetëdijësim. Donatorët si USAID, SIDA dhe AER-i janë përpjekur ta reformojnë dhe rindërtojnë tërë strukturën e sistemit të drejtësisë. Vlen të përmendet programi i financuar nga USAID për zhvillimin profesional ligjor dhe programet e udhëhequra nga Qendrat Kombëtare për Gjykata Shtetërore. Shoqata Amerikane e Provimit të Jurisprudencës dhe SIDA u përqendruan në trajnimin e gjykatësve, prokurorëve dhe avokatëve mbrojtës.⁹² Komisioni Evropian poashtu është zotuar të jap 83.5 milion euro gjatë tri viteve të ardhshme.

Struktura institucionale është e vendosur; në Kosovë veprojnë 55 gjykata, përfshirë këtu gjykatat komunale, gjykatat për krime të vogla, gjykatat e qarkut, gjykatat komerciale dhe Gjykata Supreme.⁹³ Deri në fund të vitit 2007, në gjyqësor kanë punuar 308 gjykatës, 274 prej tyre shqiptarë, 15 serbë dhe 19 nga komunitetet e tjera minoritare.⁹⁴ Deri në

⁸⁹ Raport i OSBE-së; *Human Rights, Ethnic Relations and Democracy in Kosovo*; Vera 2007 – Vera 2008, f.3

⁹⁰ ‘*Kosovo Criminal Justice Scorecard*,’ botuar nga Human Rights Watch – mars 2008

⁹¹ Raporti i Progresit për Kosovën 2008, 5 nëntor 2008, f. 13

⁹² Kosova – Raport Teknik, Sektori i Sundimit të Ligjit, 1 korrik 2008

⁹³ Numri i gjykatave kosovare të të gjitha niveleve dhe juridiksioneve është 55; sistemi i gjykatave të Kosovës përbëhet prej 26 gjykatave komunale, 24 gjykatave për krime të vogla, 5 gjykatave të qarkut, Gjykatës Komerciale të Kosovës dhe Gjykatës Supreme.

⁹⁴ *Ibid*, f. 19 – ju lutem shihni mospërputhjen në numrin e përgjithshëm të gjykatësve 310 me 308

shkurt të vitit 2008, 12 përqind e stafit gjyqësor ishin nga pakicat etnike, përfshirë këtu edhe 8 përqind serbë.⁹⁵ Rregulloret e UNMIK-ut të miratuara që nga qershori i vitit 1999 kanë ndihmuar që sistemi ligjor ta zë hapin me standardet dhe kriteret bashkëkohore të të drejtave të njeriut. Problemet, megjithatë, gjenden më thellë.

Në vitin 1999, UNMIK-u nxitoi në themelimin e Sistemit Emergjent Gjyqësor; Këshilli i Përbashkët Konsultativ i përbërë nga përfaqësuesit kosovarë dhe ndërkombëtarë emëroi grupin e parë prej 55 gjykatësve dhe prokurorëve.⁹⁶ Në mungesë të alternativave tjera, këta gjykatës u zgjodhën nga një numër i gjykatësve që kishin punuar në sistemin e vjetër. Në të kaluarën, gjykatësit dhe prokurorët në Kosovë ishin të mësuar ta zbatonin cilëndo ‘linjë zyrtare’ të kohës. Në fund të fundit, Jugosllavia e Titosë ishte shtet autoritar ku nocioni i paanshmërisë gjyqësore ekzistonte vetëm në letër. Gjatë viteve të 90-ta, gjyqësori u bë pjesë e makinerisë represive shtetërore të Millosheviqit; shumica e gjykatësve dhe prokurorëve shqiptarë u dëbuan nga vendet e tyre të punës.

Mungesa e kuadrove të reja dhe stafit të trajnuar është njeri ndër problemet më të mëdha me të cilin ballafaqohet gjyqësori i Kosovës. Raporti i fundit i Komisionit Evropian poashtu ka cekur moshën mesatarisht të shtyer të gjykatësve aktiv.⁹⁷ Raundi i ri i emërimeve, ekzaminimeve dhe rimeërimeve të gjykatësve ishte planifikuar të fillojë në vitin 2006. Por, siç thuhet në Raportin e Progresit, pothuajse asnjë gjykatës dhe prokuror i ri nuk është rekrutuar që prej vitit 2001; vendet e lira të punës janë mbushur duke i rivendosur gjykatësit dhe prokurorët.⁹⁸

Mungesa e trajnimit dhe arsimimit gjyqësor është poashtu problem i madh. Shumica e gjykatësve aktiv nuk e kanë kaluar provimin e jurispruencës, edhe pse Neni 14 i Ligjit për Gjykatat thotë që ‘gjykatësi duhet të ketë: kryer me sukses provimin e jurispruencës dhe provimin e veçantë për gjykatës.’⁹⁹ Si masë e përkohshme është themeluar Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorë për ‘hartimin e rishikimit përmbajtjesor në mbarë Kosovën për qëndrueshmërinë e të gjithë aplikantëve për emërime të përhershme.’¹⁰⁰ Të gjithë kandidatët poashtu duhet ta kalojnë provimin e Kodit Etik.

Sundimi i ligjit po ashtu pengohet edhe nga konfuzioni ligjor i shkaktuar nga ekzistenca e burimeve paralele të legjisllacionit; ligjet e ish-Jugosllavisë vazhdojnë të zbatohen së bashku me Rregulloret e UNMIK-ut dhe ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Politika e UNMIK-ut që të qëndroj neutral ndaj statusit nënkupton që kjo administratë

⁹⁵ 12% e stafit në të gjitha institucionet gjyqësore janë pjesëtarë të komuniteteve pakicë dhe rreth 8% janë serbë, vetëm 1% të gjykatësve i takojnë një grupi të pakicave dhe 0.5% i takojnë pakicës serbe. Vetëm gjashtë prej 88 prokurorëve janë pjesëtarë të pakicave.

⁹⁶ Michael E. Hartman, ‘International Judges and Prosecutors in Kosovo’, Raport Special 112, Instituti Amerikan për Paqë, tetor 2003, f. 8, <http://www.usip.org/pubs/specialreports/sr112.pdf>

⁹⁷ Raporti i Progresit për Kosovën 2008, 5 nëntor 2008, f. 13

⁹⁸ Kosova – Raport Teknik, Sektori i Sundimit të Ligjit, 1 korrik 2008

⁹⁹ Ligji për Gjykatat; Neni 14 (5), (6); Kuvendi i Kosovës, 2008

¹⁰⁰ Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut Nr. 2006/18; 28 dhjetor 2006

nuk i njeh ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës që nuk njihen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.¹⁰¹ Kjo vetëm sa i përkeqëson gjërat. Pakicat etnike kanë hezitur t’iu drejtohen gjykatave kosovare, me frikë se nuk do të kenë trajtim korrekt. Si rezultat i kësaj, gjykatat paralele vazhdojnë të operojnë në vendbanimet serbe dhe Qeveria e Kosovës ka autoritet të kufizuar mbi policinë dhe gjykatat.¹⁰² Komunitet në pjesën veriore të Kosovës, kohëve të fundit kanë filluar të zbatojnë legjislacionin e Serbisë. Kështu, në një territor të vogël si Kosova tash ekzistojnë katër legjislacione të ndryshme.

Numri i madh i lëndëve të pazgjidhura gjyqësore paraqet një problem tjetër serioz në sistemin e drejtësisë. Deri më sot, më tepër se 100,000 raste civile dhe mbi 36,000 raste penale presin të zgjidhen. Gjykata Supreme ka më tepër se 2000 raste të pazgjidhura. Numri i rasteve të pazgjidhura civile në gjykatat komunale është 160,477.¹⁰³ Ekzistojnë edhe disa qindra raste të pazgjidhura vendore të krimeve të luftës. Kapaciteti menaxhues në gjykata është qartë i pamjaftueshëm; nuk ekziston një sistem operacional për ekzekutimin e vendimeve civile.¹⁰⁴ Kushtet e dobëta ekzistuese të punës dhe pagat e ulëta nuk ndihmojnë në përmirësimin e punës së gjykatësve dhe prokurorëve. Pagat e gjykatësve dhe prokurorëve janë prej 350 deri në 620 euro në muaj – që është pak më pak se paga mujore e një pastruesi që punon në UNMIK.¹⁰⁵ Në fund por shumë e rëndësishme, zyrat e prokurorëve kanë mungesë të jashtëzakonshme të stafit dhe nuk kanë pajisje bazike dhe trajnime të specializuara. Sa i përket teknologjisë dhe ekspertizës, kriminelët janë tejet më mirë të pajisur se gjyqësori.

Në mënyrë që ta luftoj më me efikasitet krimin e organizuar dhe korrupsionin, Kosova duhet të ketë gjyqësor transparent, të pavarur dhe efektiv. Reforma e gjyqësorit është poashtu parakusht për progresin e Kosovës drejt integriteteve evropiane në të ardhmen e afërt. Me ndihmën e donatorëve dhe misionit të BE-së për sundim të ligjit, Qeveria e Kosovës duhet të bëjë krejt çka është e mundur për të siguruar që gjykatat të jenë të paanshme, efektive dhe të lira nga ndikimi politik, që të zvogëlohet numri i lëndëve të pazgjidhura, që të përmirësohet shkollimi ligjor dhe të forcohet prokuroria publike. Nuk mjaftojnë vetëm fjalët e bukura për reformën e gjyqësorit; duhet të bëhen përmirësime të dukshme.

Policia e Kosovës

Një gjë është e sigurtë; në Kosovë nuk ka mungesë të policëve. Për kokë banori, Kosova ka numër më të madh të policëve se Singapuri. Zyra e OKB-së për Drogë dhe Krim ka vlerësuar që ‘Kosova me gjasë ka përqendrimin më të madh të stafit të sigurisë në

¹⁰¹ Raporti i Progresit për Kosovën i Komisionit të Komuniteteve Evropiane; 5 nëntor, z 2008

¹⁰² Commission of European Communities, Kosovo 2008 Progress Report; November 05, 2008

¹⁰³ Raporti i Progresit për Kosovën i Komisionit të Komuniteteve Evropiane; 5 nëntor 2008, f.14

¹⁰⁴ Raporti i Progresit për Kosovën i Komisionit të Komuniteteve Evropiane; 5 nëntor 2008, f.12

¹⁰⁵ Pastruesi në UNMIK merr afro 700 euro në muaj

botë.¹⁰⁶ Aktualisht, në mbarë territorin e Kosovës janë 26,233 kuadro të sigurisë, përfshirë këtu 15,900 ushtarë të KFOR-it, 1,499 policë të UNMIK-ut dhe 8,834 policë të Kosovës.¹⁰⁷ Me fjalë tjera, Kosova ka nga një polic për çdo 22 banorë mashkull.

Në vigjilje të pavarësisë, Shërbimi Policor i Kosovës ishte institucion i respektuar multi-etnik. Mbi 14 përqind të policëve ishin pjesëtarë të komuniteteve pakicë, përfshirë këtu 822 policë serb apo 9.3 përqind dhe 413 apo 5 përqind të pakicave joserbe. Forca policore kishte 1,531 police femra, një shkallë mbresëlënëse prej 15 përqind.¹⁰⁸

Për dallim nga gjyqësori, Policia e Kosovës është ndërtuar nga zeroja. Vetëm një fjali e shkurtë në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së përmendte themelimin e forcës policore vendore. Rezoluta 1244 bënte thirrje për mirëmbajtjen e rendit dhe ligjit civil, për themelimin e forcës policore vendore dhe për zbatimin e policisë ndërkombëtare në Kosovë.¹⁰⁹ Përgjegjësia kryesore për ndërtimin e forcës policore të Kosovës ishte në duart e Shtyllës së Parë të UNMIK-ut; ky proces zgjati gjashtë vite. Në dhjetor të vitit 2005, Rregullorja 2005/54 e UNMIK-ut themeloi Shërbimin Policor të Kosovës.

Në shtator të vitit 1999, Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës e financuar nga OSBE-ja, në Vushtrri, hapi dyert e saj për gjeneratën e parë të rekrutëve.¹¹⁰ Deri sot, kjo shkollë ka trajnuar 35 gjenerata të policëve. Në vitin 2007, Shërbimi Policor i Kosovës morri autoritetin ekzekutiv mbi shkollën dhe shkolla është riemëruar si Akademia për Siguri Publike dhe Zhvillim.¹¹¹ Donatorët ndërkombëtarë kanë shpenzuar rreth 66.11 milion euro për ndërtimin e forcës policore prej vitit 1999 deri në vitin 2004; kontribuesit më të mëdhenj ishin SHBA-të dhe Kanadaja.¹¹²

Versioni i ri i Ligjit për Policinë hyri në fuqi më 15 korrik 2008, por mandatet dhe përgjegjësitë e Policisë së Kosovës, policisë së UNMIK-ut dhe EULEX-it mbesin të paqarta dhe përplotë konfuzion; Policia e Kosovës akoma nuk ka kompetenca të plota. Ligji i ri parasheh që shërbimi policor duhet të jetë nën drejtimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e Drejtorit të Përgjithshëm, përgjegjës për tërë Kosovën.¹¹³ Sipas UNMIK-ut, Policia e Kosovës është ende nën autoritetin e drejtpërdrejt të PSSP-së dhe nën kontrollin e Komisionerit ndërkombëtarë të Policisë së UNMIK-ut.¹¹⁴ Departamenti për hetimin e krimeve, krimit të organizuar, kundër terrorizmit dhe analizimit të krimeve mbetet nën mbikëqyrjen e policëve të OKB-së. Komanda rajonale për rajonin e

¹⁰⁶ Raport i UNODC, Maj 2008: www.unodc.org

¹⁰⁷ Fact Sheet i UNMIK-ut shkurt Fact 2008 & intervistat me zyrtarët e lartë të KFOR-it.

¹⁰⁸ UNMIK Factsheet, shkurt 2008

¹⁰⁹ Rezoluta 1244 e KS të OKB-së (1999); 11 (i), qershor 10, 1999

¹¹⁰ Misioni i OSBE-së në Kosovë, www.osce.org/publications/

¹¹¹ F. Harris, 'The Role of Capacity-Building in Police Reform,' OSCE Mission in Kosovo publication, 2005 Prishtina

¹¹² MEF, 'Annual Report on Donor Activities in Kosovo,' Jan 2004 – Dec 2005, pg.4

¹¹³ Ligji për Policinë i Kuvendit të Kosovës, Kapitulli III, Neni 31 (1) dhe 32 (1)

¹¹⁴ Rregullorja e UNMIK-ut 2005/54, Për Kornizën dhe Principet Udhëzuese për Shërbimin Policor të Kosovës

Mitrovicës ende nuk është transferuar nga UNMIK-u në Policinë e Kosovës; prandaj zbatimi i ligjit në pjesën veriore të Kosovës mbetet përgjegjësi ekskluzive e UNMIK-ut.

Kosovës i mungon strategjia kombëtare për luftën kundër krimet të organizuar, plani i veprimit dhe strategjia për uljen e shkallës së krimet. Në infrastrukturën ligjore ka zbrazëti; nuk ekziston një ligj për rregullimin e politikave të vizave, nuk ka ligj për mbrojtjen e të dhënave apo për mbrojtjen e dëshmitarëve.¹¹⁵ Poashtu mungon edhe baza qendrore e të dhënave për lidhjen e komandave rajonale dhe pikave kufitare; për momentin, Policia e Kosovës nuk ka qasje në databazat e Interpolit apo Europolit dhe kjo në masë të madhe e pengon bashkëpunimin tejkuftar për luftën kundër krimet të organizuar.¹¹⁶ Policia poashtu nuk ka staf të specializuar për luftimin e krimeve të sofistikuar siç është larja e parave apo krimet kibernetike.

Kërcënimi më i madh i vetëm ndaj sigurisë dhe stabilitetit rajonal, megjithatë, është mungesa totale e sundimit të ligjit në veri të Lumit Ibër. Pas shpalljes së pavarësisë, policët serb refuzuan të bashkëpunojnë me Prishtinën. Në vendbanimet serbe, policët e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë vazhdojnë të punojnë në mënyrë klandestine. Për momentin, MUP-i serb ka rreth 375 policë dhe 160 policë rezervë në Kosovë. 130 policë tjerë serb që punojnë në Policinë e Kosovës punojnë edhe për MUP-in, përfshirë këtu zyrtarët e lartë që kanë qasje në të dhënat e inteligjencës. Kjo i mundëson MUP-it serb nivel të lartë të kontrollit mbi pjesë të mëdha të Kosovës dhe njohuri paraprake për aktivitetet e planifikuara të Policisë së Kosovës.¹¹⁷

Djegja e orkestruar e pikave doganore dhe kufitare nga bandat serbe në mars të vitit 2008 krijoi një parajsë për kontrabandues dhe vend të sigurtë për kriminelët në veri të Lumit Ibër. Në tetë muajt e fundit, UNMIK-u ka dështuar që ta kthej kontrollin mbi doganat dhe pikat kufitare. Fakti që çmimi i naftës në Mitrovicën Veriore është për 30 përqind më i vogël se në pjesët tjera të Kosovës, është dëshmi e aktiviteve të kontrabanduesve dhe e mungesës së policisë. Status kuoja aktuale në pjesën veriore të Kosovës minon seriozisht sundimin e ligjit; ajo është poashtu shuplakë në fytyrë për Bashkimin Evropian i cili është në prag të zbarkimit të misionit të tij më të madh për sundimin e ligjit. Lajmet për kufijtë e pakontrolluar, kontrabandimin e naftës dhe aktivitetet kriminale në veri të Lumit Ibër sigurisht nuk do ta ndihmojnë Kosovën në përmirësimin e imazhit të saj në vendet tjera; përkundrazi, nëse EULEX-i nuk e mban premtimin për zbarkimin e misionit në tërë territorin e Kosovës, imazhi i Kosovës si vrimë e zezë e Evropës do të vazhdoj edhe në të ardhmen.

¹¹⁵ Intervistat e IKS me zyrtar të lartë të PK-së; Prishtinë, qershor June 2008

¹¹⁶ Intervistat e IKS me zyrtar të lartë të PK-së; Prishtinë, qershor 2008

¹¹⁷ Intervistat e IKS me zyrtarë të nivelit të lartë në Prishtinë, qershor 2008

E TASH ÇKA? (PËRFUNDIM)

Kosova duhet të veproj dhe ta trajtoj me seriozitet çështjen e imazhit të saj. Retorika dhe marrëdhëniet me publikun si të tilla nuk mjaftojnë; institucionet përgjegjëse së pari duhet ta kuptojnë problemin, të analizojnë atë me kujdes dhe në partneritet me shoqërinë civile të hartojnë një strategji të fuqishme për riformësimin e imazhit të Kosovës në vendet e tjera dhe për reformimin e institucioneve kosovare. Këto dy procese janë të lidhura ngushtë njëri me tjetrin; dhe pa reforma përmbajtjesore në vend, *brendi* 'Kosova' nuk do të mund të promovohet në arenën ndërkombëtare. Por, në mënyrë që reformat të jenë të suksesshme, Kosova duhet të ketë një perspektivë të qartë evropiane dhe jo vetëm një premtim të paqartë për anëtarësim të mëvonshëm. Ne gjithashtu u bëjmë thirrje miqve dhe partnerëve të Kosovës në Evropë të ndihmojnë në adresimin e paragjytimeve dhe klisheve që më nuk e pasqyrojnë realitetin në terren. Shumë gjëra kanë ndodhur që nga 1990-ta, dhe ka ardhur koha që imazhi i Kosovës në vendet e tjera t'i pasqyroj ndryshimet dramatike dhe zhvillimet pozitive që kanë ndodhur në vitet e fundit. Ky dokument është kontributi ynë për nxitjen e debatit tejet të nevojshëm.